



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

RREGULLORE E AKTIVITETIT

SEZONI 2023-2024



**ABISSNET
SUPERIORE**



**KUPA E
SHQIPËRISË**



Federata Shqiptare e Futbollit

RREGULLORE E VEPRIMTARISË FUTBOLLISTIKE

SEZONI 2023-2024

ABISSNET SUPERIORE
KUPA E SHQIPËRISË

Botim zyrtar, 2023

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretar i Përgjithshëm:

Illir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare në UEFA: 1954

Anëtare në FIFA: 1930

Realizoi botimin: “Reklama”

PËRMBAJTJA

I. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME	7
Neni 1 - Qëllimi i Aplikimit	7
Neni 2- Përkufizime	7
Neni 3 - Regjistrimi në Garë	9
Neni 4 - Kriteret dhe procedurat e pranimit në garë	9
Neni 5 - Integriteti i Garës	11
Neni 6 - Detyrimet e klubeve	12
Neni 7 - Ndeshje miqësore	14
Neni 8 - Përgjegjësitë e klubeve pjesëmarrëse	14
Neni 9 - Anti-Doping	15
Neni 10 - Fair Play	15
Neni 11 - Siguracioni	15
Neni 12 - Trofetë dhe medaljet	15
Neni 13 - Pronësia industriale e intelektuale	17
Neni 14 - Zyrtarët e ndeshjes	17
Neni 15 - Rregullat e kontratave	18
Neni 16 - Periudhat e transferimit	19
Neni 17 - Pjesëmarrja në garat e UEFA-s	19
II. FORMATI I GARËS	20
Neni 18 - Numri i ekipeve pjesëmarrëse në garë	20
Neni 19 - Skema e shortit	21
Neni 20 - Fazat e garës	21
Neni 21 - Klasifikimi	23
Neni 22 - Fituesi i “Abissnet Superiore”	24
Neni 23 - Rënia nga dhe ngritja në “Abissnet Superiore”	24
Neni 24 - Ndeshja “Play-off” Abissnet Superiore	24

III. KUPA E SHQIPËRISË	26
Neni 25 - Emërtimi i Garës	26
Neni 26 - Skema e “Kupës së Shqipërisë”	26
Neni 27 - Kupa e Shqipërisë, Sezoni 2023-2024	27
Neni 28 - Rregullat e kualifikimit	30
IV. SUPERKUPA E SHQIPËRISË	31
Neni 29 - Emërtimi i Garës	31
Neni 30 - Rregullat e Kualifikimit	31
V. KALENDARI I GARËS	32
Neni 31 - Datat dhe oraret e ndeshjeve	32
Neni 32 - Ndryshimi i datës dhe orës së ndeshjeve	32
Neni 33 - Mbërritja e skuadrave	32
Neni 34 - Shtyrja e ndeshjes	32
Neni 35 - Shtyrja ose riluajtja e ndeshjes	33
Neni 36 - Refuzimi për të luajtur dhe situata të ngjashme	34
VI. INFRASTRUKURA SPORTIVE	36
Neni 37 - Stadiumet	36
Neni 38 - Fusha e lojës	36
Neni 39 - Fushat me bar artificial	37
Neni 40 - Sistemi i ndriçimit	37
Neni 41 - Ora dhe ekranet në stadium	37
Neni 42 - Ora diellore e ndeshjeve	38
VII. ORGANIZIMI I NDESHJEVE	39
Neni 43 - Pajisjet e ndeshjes	39
Neni 44 - Stërvitja përpara ndeshjes	40
Neni 45 - Deklarimi i biletave	40
VIII. PROÇEDURAT E NDESHJEVE	41
Neni 46 - Formulari i ekipeve	41

Neni 47 - Aspekte protokollare te ndeshjes	42
Neni 48 - Zona teknike dhe stoli i rezervave	43
IX. REGJISTRIMI I LOJTARËVE DHE ZYRTARËVE	44
Neni 49 - Kriteret për regjistrimin e lojtarëve	44
Neni 50 - Lista e lojtarëve	44
Neni 51 - Aktivizimi i lojtarëve	45
Neni 52 - Trofeu “Lojtari më i mirë i vitit”	47
Neni 53 - Trofeu “Golashënuesi më i mirë”, Abissnet Superiore	47
X. ARBITRIMI	49
Neni 54 - Emërimi dhe zëvendësimi i arbitrave	49
XI. ÇËSHTJE DISIPLINORE	50
Neni 55 - Kodi i Disiplinës Sportive	50
Neni 56 - Kartonat	50
Neni 57 - Reklamimet	51
Neni 58 - Zhvillimi i ndeshjes pa spektatorë	52
Neni 59 - Lojtarët, trajnerët dhe zyrtarët e pezulluar	52
XII. UNIFORMAT E LOJËS	53
Neni 60 - Aprovimi i uniformave	53
Neni 61 - Ngjyrat	53
Neni 62 - Numrat dhe emrat	53
Neni 63 - Sponsorët në fanellë	54
Neni 64 - Stemat	54
XIII. ÇËSHTJE FINANCIARE	55
Neni 65 - Shpërblimet nga FSHF	55
Neni 66 - Detyrimet financiare për pjesëmarrje në garë	55
Neni 67 - Llogaritë bankare të klubeve	55
Neni 68 - E drejta e ekzekutimit të detyrimeve	56

XIV. SHFRYTËZIMI I TË DREJTAVE TREGTARE	57
Neni 69 - Hyrje	57
Neni 70 - Të drejtat tregtare	57
Neni 71 - Të drejtat tregtare gjatë turit 1/16 të Kupës së Shqipërisë.	58
Neni 72 - Të drejtat tretarë gjatë Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë	58
Neni 73 - Të drejtat tregtare të Abissnet Superiore	59
Neni 74 - Liçensimi dhe tregtimi i produkteve	59
XV. MARRËDHËNIET ME MEDIAT	60
Neni 75 - Përgjegjësitë lidhur me çështjet e medias	60
Neni 76 - Intervistat një ditë përpara ndeshjes	60
Neni 77 - Intervistat në ditën e ndeshjes	60
Neni 78 - Aksesit i mediave	61
Neni 79 - Hapësirat e punës për mediat	62
Neni 80 - Hapësirat e punës për transmetuesit audio vizual	62
XVI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	63
Neni 81 - Zbatimi i rregullores	63
Neni 82 - Raste të pa parashikuara	63
Neni 83 - Mos respektimi i rregullores	63
Neni 84 - Anekset	53
Neni 85 - Miratimi dhe hyrja në fuqi	64
Aneksi 1: Formulari i regjistrimit në garë	65
Aneksi 2: Kalendari i ndeshjeve sezoni 2023-24	70
Aneksi 3: Lista e lojtarëve të trajnuar në klub	74
Aneksi 4: Kontrata Standarde e Lojtarit	76
Aneksi 5: Uniformat	90
Aneksi 6: Rregullorja e <i>Fair-Play</i>	91

I. PARASHIKIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi i Aplikimit

1.1 Kjo rregullore parashikon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve që marrin pjesë dhe janë të përfshira në përgatitjen dhe pjesëmarrjen në veprimtarinë futbollistike të Abissnet Superiore, Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë.

Neni 2- Përkufizime

2.1. Për qëllimet e kësaj rregullore, vlejnjë përkufizimet e mëposhtme:

- a. **FSHF:** Federata Shqiptare e Futbollit;
- b. **Stadium:** është stadiumi i liçensuar për tu zhvilluar ndeshjet e Abissnet Superiore, Kupë së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë;
- c. **Përpara ndeshjes:** është koha ndërmjet mbërritjes së ekipeve në stadium dhe nisjes së lojës;
- d. **Pas ndeshjes:** është koha ndërmjet fishkëllimës finale të arbitrit dhe largimit të ekipeve nga stadiumi;
- e. **Ndeshje zyrtare:** ndeshje futbollit e organizuar nën mbikëqyrjen e FSHF, rezultati i së cilës është i vlefshëm për garat e organizuara nga FSHF;
- f. **Ndeshje miqësore:** është ajo ndeshje e organizuar nga FSHF, ndonjë klub apo person midis ekipeve të ndryshme të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme, dhe rezultati ka efekt vetëm për këtë ndeshje apo turne;
- g. **Sezon futbollistik:** është periudha që fillon më datë 1 korrik, dhe përfundon më datë 30 qershor të ardhshëm;

- h. Zyrtar:** çdo person, me përjashtim të lojtarëve, që kryen një detyrë për llogari të një klubi pjesëmarrës në garë apo të FSHF-së;
- i. Rregulloret e FSHF:** ligjet e lojës së IFAB, statuti, rregulloret, udhëzimet, urdhrat e nxjerra nga FSHF të detyrueshme për t'u zbatuar nga pjesëmarrësit në garë.
- j. Të drejta tregtare:** çdo e drejtë tregtare dhe mundësi që lidhen me kompeticionin përfshirë të drejtat e medias, marketingut dhe të drejtat e lidhura me statistikat;
- k. Të drejtat e statistikave:** e drejta për të përpiluar dhe shfrytëzuar statistikat dhe të dhëna të tjera që lidhen me kompeticionin;
- l. Doping:** shkëlja e një ose më shumë prej rregullave të përcaktuara të rregullave antidoping të parashikuara në Rregulloren e Anti-Dopingit të UEFA-s;
- m. Ekip A:** Ekipi i Parë;
- n. Ekip B:** Ekipi i Dytë;
- o. Klubi pritës:** klubi në fushën e të cilit zhvillohet një ndeshje e kësaj gare;
- p. Të drejtat e marketingut:** e drejta për të reklamuar, promovuar, miratuar dhe tregtuar garën; për të zhvilluar aktivitete të marrëdhënieve me publikun në lidhje me garën; dhe shfrytëzimi i të gjitha reklamave, sponsorizimeve, hotelerisë dhe liçenimeve, tregtimin, botimin, lojërat, shitjen me pakicë, muzikë dhe ekskluzivitet mundësitë dhe të gjitha të drejtat e tjera tregtare që lidhen me garën;
- q. Të drejtat e mediave:** e drejta për të krijuar, shpërndarë dhe transmetuar në një linear dhe/ose kundrejt kërkesës kudo me çdo mënyrë dhe në të gjitha mënyrat, në cilindo dhe të gjitha mediat, pavarësisht nëse dihen tani ose krijohen në të ardhmen (përfshirë të gjitha format e televizionit, radio, celular, wireless dhe shpërndarja e internetit), mbulimi dixhital, audiovizual, vizual dhe / ose audio i konkurrencën

dhe të gjitha të drejtat e lidhura dhe / ose të lidhura, përfshirë edhe ato fikse, shkarkime dhe të drejta ndërvepruese;

- r. **Partner:** çdo palë e pranuar nga FSHF sipas kontratës për të ushtruar të drejtat tregtare të garës, dhe që merr pjesë direkt ose indirekt në financimin e garës;
- s. **Zona teknike:** zona teknike siç përcaktohet në Ligjet e Lojës së IFAB që përfshin fushën e lojës, si dhe dhomat e zhveshjes së gjyqtarëve, tuneli i lojtarëve dhe rruga që lojtarët dhe gjyqtarët marrin nga dhomat e zhveshjes në fushë.

2.2. Në kontekstin e kësaj rregulloreve, çdo frazë e prezantuar nga termat “përfshirë”, “përfshijnë”, “në veçanti”, “për shembull” ose ndonjë shprehje e ngjashme është ilustruese dhe nuk kufizon kuptimin e fjalëve që u paraprijnë këtyre termave.

Neni 3 - Regjistrimi në Garë

3.1. Çdo anëtar dhe/ose pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara nga FSHF i cili është kualifikuar në kategorinë përkatëse me meritë sportive duhet të regjistrohet në Garë.

Neni 4 - Kriteret dhe procedurat e pranimit në garë

4.1. Për të marrë pjesë në garë, klubet anëtarë dhe/ose pjesëmarrës në aktivitetet e organizuara nga FSHF duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- a. Të jenë kualifikuar në kategorinë përkatëse me meritë sportive.
- b. Të jenë liçencuar nga organi juridik përkatës i FSHF për të marrë pjesë në kategorinë përkatëse.
- c. Të plotësojnë dokumentacionin zyrtar të regjistrimit brenda afatit të përcaktuar nga FSHF.
- d. Të konfirmojnë me shkrim se ato vetë, lojtarët dhe zyrtarët e tyre do të zbatojnë këtë rregullore, Kodet dhe Rregulloret e tjera si dhe do të respektojnë ligjet e lojës së IFAB.

- e. Të konfirmojnë me shkrim se ato vetë, lojtarët dhe zyrtarët e tyre do të njohin juridiksionin e organeve juridike të FSHF, duke përfshirë por pa u kufizuar me CAS, Komisionin e Disiplinës, Komisionin e Apelit, Komisionin e Etikës, Komisionin e Liçensimit të Klubeve dhe Komisionin e Apelit për liçensimin e klubeve etj.
 - f. Të konfirmojnë me shkrim se nuk janë të përfshire direkt ose indirekt në veprimtari të cilat synojnë të influencojnë mbarëvajtjen apo rezultatin e një ndeshje futbollit në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.
 - g. Të informojnë me shkrim FSHF lidhur me çdo procedim përpara organeve juridike të FSHF apo atyre shtetërore ku klubi apo lojtarët dhe/ose zyrtarët e tij janë palë ose kanë cilësinë e të pandehurit apo ndonjë cilësi tjetër procedurale.
- 4.2. Nëse mbi baza të fakteve dhe informacioneve në dispozicion të FSHF, FSHF konkludon se klubi ka qenë i përfshirë direkt ose indirekt në veprimtari të cilat synojnë të influencojnë mbarëvajtjen apo rezultatin e një ndeshje futbollit në nivel kombëtar apo ndërkombëtar, FSHF ka të drejtë ta shpallë këtë klub të papërshtatshëm për të marrë pjesë në garë. Papërshtatshmëria për efekt të këtij neni do të zgjasë vetëm për një sezon futbollistik.
- 4.3 Përveç masave administrative për shpalljen e një klubi të papërshtatshëm në kuptim të paragrafit 4.2, organet juridike të FSHF mund, nëse rrethanat e lejojnë, të ndërmarrin masa disiplinore në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive.
- 4.4 Një klub i cili nuk pranohet në garë, do të zëvendësohet nga klubi i cili është renditur më mirë sportivisht në garën përkatëse të FSHF, me kusht që të përmbushë kriteret e pranimit. Për qëllimet e kësaj dispozite, për evidentimin e ekipit të renditur më mirë do të ndiqen parimet e mëposhtme:
- i. numri i pikëve të grumbulluara në fund të sezonit paraardhës në grupin përkatës;
 - ii. diferenca e golave të shënuar dhe atyre të pësuar gjatë sezonit;

- iii. numri më i madh i golave të shënuar gjatë sezonit;
 - iv. me short;
- 4.5. Në rast se një klub refuzon të regjistrohet në garë, edhe pse është kualifikuar me meritë sportive dhe është pajisur me licencën përkatëse, do të zëvendësohet nga klubi i cili është renditur më mirë sportivisht në garën përkatëse sipas parimeve të parashikuara në Nenin 4.4.

Neni 5 - Integriteti i Garës

- 5.1. Për të garantuar integritetin e garës, do të zbatohen kriteret e mëposhtme:
- a. Asnjë klub pjesëmarrës në garat e organizuara nga FSHF nuk lejohet, që në mënyre direkte ose të tërthortë:
 - i. të ketë në pronësi aksione të një klubi tjetër pjesëmarrës në garat e FSHF;
 - ii. të jetë anëtar i një klubi tjetër pjesëmarrës në garat e FSHF-së;
 - iii. të mos jetë i përfshirë në asnjë mënyrë në menaxhimin, administrimin dhe/ose performancën sportive të ndonjë klubi pjesëmarrës në garat e FSHF-së;
 - b. Askush nuk mund të jetë i përfshirë në asnjë mënyrë, qoftë direkte apo të tërthortë në ndonjë cilësi në menaxhimin, administrimin dhe/ose performancën sportive të më shumë se një klubi pjesëmarrës në garat e FSHF-së.
 - c. Asnjë individ apo entitet ligjor nuk mund të ketë kontroll apo influencë mbi më shumë se një klub pjesëmarrës në garat e FSHF. Për qëllimin e kësaj dispozite, ky kontroll apo influencë do të përkufizohet si:
 - i. zotërimi i kuotave mazhoritare apo numër mazhoritar votash;
 - ii. e drejta për të emëruar apo shkarkuar anëtarë të bordit, këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ndonjë organi administrativ të klubit;

- iii. qënia si aksionar mazhoritar dhe kontrolli i të drejtës së votës përmes ndonjë marrëveshje të nënshkruar me një klub;
 - iv. influencimi në ndonjë mënyrë i procesit vendimmarrës të klubit.
- 5.2 Në rast se dy ose më shumë klube dështojnë në përbushjen e këtyre parashikimeve, vetëm një klub do të lejohet të marrë pjesë në garë sipas kriterit të meritës sportive.
- 5.3 Klubet që nuk pranohen në garë zëvendësohen sipas parashikimeve të nenit 4.4.

Neni 6 - Detyrimet e klubeve

- 6.1 Me regjistrimin në garë, klubet pjesëmarrëse bien dakord që:
- a. Të marrin pjesë në Abissnet Superiore, duke rreshtuar lojtarët më të mirë në dispozicion përgjatë gjithë garës.
 - b. Të marrin pjesë në Kupën e Shqipërisë, deri në eliminimin e tyre, apo në Superkupën e Shqipërisë duke rreshtuar lojtarët më të mirë në dispozicion përgjatë gjithë garës.
 - c. Të luajnë të gjitha ndeshjet në përputhje me këtë rregullore dhe me parimet e lojës së ndershme (*fair play*).
 - d. Të luajnë të gjitha ndeshjet nën drejtimin e një trajneri të pajisur me Licencën “UEFA PRO”
 - e. Të zbatojnë statutin dhe të gjitha rregulloret në fuqi.
 - f. Të zbatojnë vendimet e Komitetit Ekzekutiv të FSHF, administratës së FSHF apo çdo organi tjetër të FSHF që u komunikohet rregullisht (me publikim, shkresë apo e-mail).
 - g. Të bashkëpunojnë me FSHF dhe njëri tjetrin për mbarëvajtjen e aktivitetit sportiv duke mos dëmtuar interesat e përbashkëta.
 - h. Të mos përfaqësojë FSHF në asnjë rrethanë pa pasur autorizimin përkatës me shkrim.
 - i. Të mos përhapin fakte të pavërteta, të mos fyejnë, shpifin apo

denigrojnë klubet e tjera pjesëmarrëse, lojtarët apo zyrtarët e tyre, si dhe të mos çenojnë interesat e FSHF.

- j. Të informojnë FSHF me shkrim brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim lidhur me ndryshime të mundshme të listës së lojtarëve, zyrtarëve apo kriterëve fillestare të regjistrimit.
 - k. Kur është e aplikueshme, të marrin pjesë si fitues në Superkupën e Shqipërisë;
 - l. Të bashkëpunojnë me FSHF për të garantuar respektimin e protokolleve përkatëse lidhur me ceremonitë zyrtare të organizuara nga FSHF.
 - m. Të paguajnë një kuotë anëtarësimi prej 200,000 (dyqind mijë) lekësh, në llogarinë bankare të FSHF-së për çdo sezon futbollistik;
- 6.2 Klubet janë të detyruara të përfshijnë në listën e stafit teknik deri në 7 (shtatë) zyrtarë gjithsej si më poshtë:
- I. Trainieri i Parë
 - II. Zv. Trainieri
 - III. Trainieri i Portierëve
 - IV. Përgatitësi atletik
 - V. Mjeku
 - VI. Fizioterapisti
 - VII. Drejtori Sportiv
- 6.3. Klubet mund të punësojnë në ekipet e tyre trainier të licensuar si më poshtë:
- a. Për Kategorinë Superiore trainieri i parë duhet të ketë minimalisht licencë UEFA "PRO", zv.Trainieri UEFA "A", Trainieri i Portierave UEFA "B" dhe përgatitësi atletik licensën përkatëse.
 - b. Në rast se një trainier është i regjistruar në kursin pasardhës UEFA "PRO" dhe UEFA "A", mund të drejtojë një ekip në sezonin përkatës.

- c. Në rast të ndryshimeve të stafit teknik klubet kanë afat deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për zëvendesimet e stafit.

Neni 7 - Ndeshje miqësore

- 7.1 Asnjë klub nuk ka të drejtë të organizojë ndonjë ndeshje miqësore gjatë periudhës së sezonit futbollistik, në mënyrë të tillë që të ndikojë kalendarin e ndeshjeve të kampionatit.
- 7.2 Për çdo ndeshje miqësore që klubet do të organizojnë brenda ose jashtë vendit janë të detyruara të paraqesin kërkesën pranë FSHF-së.
- 7.3 Klubet që nuk do të zbatojnë këtë rregull do të jenë pjesë e Komisionit të Disiplinës Sportive.

Neni 8 - Përgjegjësitë e klubeve pjesëmarrëse

- 8.1 Klubet pjesëmarrëse në garë janë përgjegjës për sjelljen e lojtarëve, zyrtarëve dhe spektatorëve të tyre si dhe të çdo personi i cili kryen ndonjë funksion në emër e për llogari të klubit.
- 8.2 Klubi pritës është përgjegjës për rendin dhe sigurinë përpara, gjatë dhe pas ndeshjes duke mbajtur përgjegjësi disiplinore.
- 8.3 Klubi pritës duhet të organizojë ndeshje në përputhje me instruksionet e FSHF-së dhe në bashkëpunim me klubin mik duke qenë përgjegjës për marrjen e masave organizative.
- 8.4 Klubi pritës është përgjegjës për zbatimin e rregullores mjekësorë të FSHF-së.
- 8.5 Klubet pjesëmarrëse kanë përgjegjësinë për të mbrojtur interesat e FSHF-së duke e përjashtuar nga çdo përgjegjësi dhe detyrim financiar, penal, administrativ i çdo natyre që mund të lindë nga gara.

Neni 9 - Anti-Doping

- 9.1 Dopingu është i ndaluar dhe i dënueshëm. Në rast të shkeljes se rregullave anti-doping, FSHF do të nisë procedim disiplinor kundër shkelësve duke marrë masat e përshtatshme.
- 9.2 FSHF apo ndonjë entitet i caktuar prej sajë, mund të testojë një lojtar në çdo kohë.

Neni 10 - Fair Play

- 10.1 Të gjitha ndeshjet e Abissnet Superiore, Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë duhet të luhen në përputhje me parimet e lojës së ndershme (fair-play) siç përkufizohet në statutin e UEFA-s.
- 10.2 FSHF kryen vlerësime të posaçme për të bërë renditjen e ekipeve më fair sipas rregullores përkatëse në aneksin Nr.5.
- 10.3 Në fund të sezonin përkatës ekipi që ka grumbulluar më shumë pikë në klasifikimin (fair-play) do të marrë një shumë prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, për klubin përkatës të Abissnet Superiore.

Neni 11 - Siguracioni

- 11.1 Çdo klub duhet të kryejë mbulimin me siguracion nëpërmjet një shoqërie sigurimesh për lojtarët stafit teknik dhe administrativ që ka në kontratë.

Neni 12 - Trofetë dhe medaljet

- 12.1 Trofeu origjinal i Abissnet Superiore dhe Kupës së Shqipërisë që përdoret në prezantimin zyrtar të, është pronë e FSHF-së. Një replikë origjinale do t'i dorëzohet fituesit Abissnet Superiore dhe/ose Kupës së Shqipërisë.
- 12.2 Replika origjinale e trofeut e cila i dorëzohet fituesit, duhet të mbetet në posedimin e klubit në çdo kohë dhe nuk mund të

zhvendoset nga selia e klubit pa lejen me shkrim të FSHF. Klubet nuk duhet të lejojnë që trofeu të përdoret nga palë të treta, përfshirë edhe sponsorët e tyre, në kontekstin e një lidhje apo bashkëpunimi mes palës së tretë dhe trofeut dhe/ose garës përkatëse apo FSHF.

12.3 Ekipyt Kampion “Final 4” Abissnet Superiore do t’i dorëzohen përmes një ceremonie zyrtare:

- a. Kupa e Kampionit të Abissnet Superiore;
- b. 30 (tridhjetë) medalje ari;
- c. Një shpërblim prej 10.000.000 (dhjetë milion) lekë në formën e një çeku bankar

12.4 Pas përfundimit të 4 fazave, skuadrat e renditura në vendin e 1 (parë), 2 (dytë), 3 (tretë) dhe të 4 (katërt) do të përfitojnë bonuse financiare sipas tabelës si më poshtë:

TABELA	
Renditja	Bonus në Lek
Vendi 1-rë	10,000,000
Vendi 2-të	7,000,000
Vendi 3-të	5,000,000
Vendi 4-të	2,000,000

12.5 Çdo 10 (dhjetë) vite, FSHF do të modelojë dhe prodhojë një edicion të ri të kupës origjinale;

12.6 Çdo herë që një klub shpallet Kampion Kombëtar në Abissnet Superiore, emri i tij do të gdhendet në trupin e kupës origjinale.

12.7 Fituesit të Kupës së Shqipërisë do t’i dorëzohen përmes një ceremonie zyrtare:

- a. Kupa e Shqipërisë
- b. 30 (tridhjetë) medalje te arta

Një shpërblim prej 5.000.000 (pesë milion) lekë në formën e një çek-u bankar;

- 12.8 Ekipit finalist të kupës së Shqipërisë do t'i dorëzohen përmes një ceremonie zyrtare 30 (tridhjetë) medalje të argjendta;
- 12.8.1. Çdo herë që një klub shpallet fitues i Kupës së Shqipërisë, emri i tij do të gdhendet në trupin e kupës origjinale.
- 12.9. Nuk lejohet prodhimi i trofeve dhe medaljeve të tjera shtesë.

Neni 13 - Pronësia industriale e intelektuale

- 13.1 FSHF është pronare ekskluzive e të gjitha të drejtave industriale dhe intelektuale të garave të organizuara prej sajë duke përfshirë të drejtat aktuale e të ardhshme të transmetimit audio vizual, material të garës, emrat, logot, markat, muzika, maskotat, medaljet, pllakadat dhe trofetë. Çdo përdorim i të drejtave të sipër cituara bëhet vetëm me autorizimin e FSHF-së.
- 13.2 Të gjitha të dhënat e kalendarit të ndeshjeve si dhe çdo statistikë apo e dhëne tjetër që lidhet me ndeshjet dhe garat, janë pronë ekskluzive e FSHF. Asnjë biletë apo akreditim nuk mund të përdoret me qëllim, aksesimin në këto të dhëna e statistika. Ky kufizim, nuk prek klubet pjesëmarrëse në garë, të cilët grumbullojnë të dhëna me qëllim instruksionin sportiv të ekipeve të tyre.

Neni 14 - Zyrtarët e ndeshjes

- 14.1 Përpara fillimit të sezonit futbollistik përkatës FSHF, do të publikojë listën e arbitrave, asistent arbitrave, vëzhguesve dhe delegatëve që plotësojnë kushtet për t'u emëruar në ndeshje.
- 14.2 FSHF ka të drejtën të heqë nga lista emrin e çdo zyrtari ndeshje në çdo kohë gjatë zhvillimit të sezonit futbollistik.
- 14.3 FSHF do të emërojë zyrtarët e ndeshjes të cilët do të jenë të caktuar në ndeshje zyrtare.
- 14.4 Pavarësisht zbatimit të pikës (3), këtu më sipër në këtë nen, FSHF ka të drejtë të ndryshojë emërimin e zyrtarëve të ndeshjes deri 12 (dymbëdhjetë) orë përpara fillimit të ndeshjes përkatëse.

- 14.5 Asnjë zyrtar ndeshje nuk duhet të ndërmarrë ndonjë veprimtari tjetër në ditën e ndeshjes pa njoftuar më parë FSHF.
- 14.6 Shpenzimet e zyrtarëve të ndeshjeve të Kampionatit Kombëtar do të mbulohen nga FSHF.

Neni 15 - Rregullat e kontratave

- 15.1 Lojtarët nën moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç nuk mund të nënshkruajnë një kontratë profesioni për një periudhë më të gjatë se 3 (tre) vjet. Çdo klauzolë që i referohet një periudhe më të gjatë nuk do të njihet.
- 15.2 Minimumi i kohëzgjatjes së një kontrate do të jetë nga data efektive e saj deri në fund të sezonit, ndërsa kohëzgjatja maksimale e kontratës do të jetë deri në 5 (pesë) vjet. Kontrata me kohëzgjatje tjetër do të lejohen vetëm nëse janë në përputhje me ligjin kombëtar.
- 15.3 Një klub është i lejuar të rinegociojë në çdo kohë kontratën e lojtarit edhe jashtë periudhave të transferimit, për të shtyrë afatin e përfundimit të kontratës. Nëse një marrëveshje e tillë arrihet midis palëve, dhe shpërblimi i ofruar për lojtarin është më i lartë se shpërblimi ekzistues, atëherë afati i kontratës aktuale mund të shtyhet për të paktën 1 (një) vit.
- 15.4 Kontrata midis një klubi dhe një lojtari do të nënshkruhet në çdo rast përpara një noteri të liçencuar ose e cikluar nga zyra juridike e FSHF-së
- 15.5 Klubi është i detyruar të dorëzojë pranë FSHF-së, kopje origjinale të kontratave të lidhura me çdo lojtar, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratave përkatëse.
- 15.6 Në rast se klubi e dorëzon kontratën më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit, klubi përkatës do të sanksionohet me gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) Lek.

Neni 16 - Periudhat e transferimit

- 16.1 FSHF përpara fillimit të sezonin futbollistik publikon periudhat e transferimit në sistemin TMS të FIFA-S.
- 16.2 Periudhat e transferimit të lojtarëve janë 2 (dy).
- 16.3 Sezon futbollistik është periudha që fillon më datë 1 korrik, dhe përfundon më datë 30 qershor të ardhshëm;

Neni 17 - Pjesëmarrja në garat e UEFA-s

- 17.1 Pjesëmarrja e ekipeve në kompeticionet e Champions League dhe të Conference League do të bëhet në bazë të ndeshjeve të Final 4.
- 17.2 Ekipi fitues i “Final 4” do të marrë pjesë në turin e parë të UEFA Champions League.
- 17.3 Ekipi i renditur në vendin e dytë dhe të tretë do të marrin pjesë në turin e parë të UEFA Conference League.
- 17.4 Ekipi fitues i “Kupës së Shqipërisë” do të marrë pjesë në turin e parë të UEFA Conference League.
- 17.5 Në rast se ekipi fitues i “Kupës së Shqipërisë” është gjithashtu i renditur në njërin prej tre vendeve të para të “Final 4”, vendin e tij, do ta zërë ekipi i renditur më mirë.

II. FORMATI I GARËS

Neni 18 - Numri i ekipeve pjesëmarrëse në garë

18.1 Në Abissnet Superiore marrin pjesë 10 (dhjetë) klube futbollit, anëtarë të FSHF-së të cilat janë liçencuar nga Komisioni i Liçencimit të Klubeve.

18.2 FSHF shpall listën e klubeve pjesëmarrëse në Abissnet Superiore për çdo sezon përmes shortit.

Neni 19 - Skema e shortit

Faza 1

Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5	Java 6	Java 7	Java 8	Java 9
1 - 10	10 - 6	2 - 10	10 - 7	3 - 10	10 - 8	4 - 10	10 - 9	5 - 10
2 - 9	7 - 5	3 - 1	8 - 6	4 - 2	9 - 7	5 - 3	1 - 8	6 - 4
3 - 8	8 - 4	4 - 9	9 - 5	5 - 1	1 - 6	6 - 2	2 - 7	7 - 3
4 - 7	9 - 3	5 - 8	1 - 4	6 - 9	2 - 5	7 - 1	3 - 6	8 - 2
5 - 6	1 - 2	6 - 7	2 - 3	7 - 8	3 - 4	8 - 9	4 - 5	9 - 1

Faza 2

Java 10	Java 11	Java 12	Java 13	Java 14	Java 15	Java 16	Java 17	Java 18
10 - 1	6 - 10	10 - 2	7 - 10	10 - 3	8 - 10	10 - 4	9 - 10	10 - 5
9 - 2	5 - 7	1 - 3	6 - 8	2 - 4	7 - 9	3 - 5	8 - 1	4 - 6
8 - 3	4 - 8	9 - 4	5 - 9	1 - 5	6 - 1	2 - 6	7 - 2	3 - 7
7 - 4	3 - 9	8 - 5	4 - 1	9 - 6	5 - 2	1 - 7	6 - 3	2 - 8
6 - 5	2 - 1	7 - 6	3 - 2	8 - 7	4 - 3	9 - 8	5 - 4	1 - 9

Faza 3

Java 19	Java 20	Java 21	Java 22	Java 23	Java 24	Java 25	Java 26	Java 27
1 - 10	10 - 6	2 - 10	10 - 7	3 - 10	10 - 8	4 - 10	10 - 9	5 - 10
2 - 9	7 - 5	3 - 1	8 - 6	4 - 2	9 - 7	5 - 3	1 - 8	6 - 4
3 - 8	8 - 4	4 - 9	9 - 5	5 - 1	1 - 6	6 - 2	2 - 7	7 - 3
4 - 7	9 - 3	5 - 8	1 - 4	6 - 9	2 - 5	7 - 1	3 - 6	8 - 2
5 - 6	1 - 2	6 - 7	2 - 3	7 - 8	3 - 4	8 - 9	4 - 5	9 - 1

Faza 4

Java 28	Java 29	Java 30	Java 31	Java 32	Java 33	Java 34	Java 35	Java 36
10 - 1	6 - 10	10 - 2	7 - 10	10 - 3	8 - 10	10 - 4	9 - 10	10 - 5
9 - 2	5 - 7	1 - 3	6 - 8	2 - 4	7 - 9	3 - 5	8 - 1	4 - 6
8 - 3	4 - 8	9 - 4	5 - 9	1 - 5	6 - 1	2 - 6	7 - 2	3 - 7
7 - 4	3 - 9	8 - 5	4 - 1	9 - 6	5 - 2	1 - 7	6 - 3	2 - 8
6 - 5	2 - 1	7 - 6	3 - 2	8 - 7	4 - 3	9 - 8	5 - 4	1 - 9

19.1 Faza "Final 4"

Pas përfundimit të 4 fazave, skuadrat e renditura në vendin e 1 (parë), 2 (dytë), 3 (tretë) dhe të 4 (katërt) do të zhvillojnë ndeshje play off sipas shortit më poshtë:

Në vazon e parë do të jenë ekipet e renditura në vendin e 1-rë dhe të 2-të ;

Në vazon e dytë do të jenë ekipet e renditura në vendin e 3-të dhe të 4-të;

Ndeshjet do të zhvillohen me një takim në stadiumin "Air Albania" Tiranë. Në rast barazimi pas 90 minutave të lojës së rregullt, skuadra e renditur më mirë në klasifikim kualifikohet për në ndeshjen finale.

-2 (dy) ekipet finaliste do të zhvillojnë ndeshje me një takim në stadiumin "Air Albania" Tiranë për të përcaktuar ekipin kampion.

Në rast se do të ketë barazim pas 90-të minutave të lojës së rregullt do të ketë:

1. Shtesë 2x15 minuta
2. Penallti

Për të përcaktuar emertimin e ndeshjes finale Final 4, do të hidhet short i lirë.

2 (dy) ekipet e eleminuara do të zhvillojnë ndeshje me një takim në stadiumin "Air Albania" Tiranë për të përcaktuar ekipin e vendit të 3-të i cili do të jetë pjesëmarrës në turin e parë të Conference League.

Për të përcaktuar emertimin e ndeshjes e vendit të 3-të të Final 4, do të hidhet short i lirë.

Në rast se do të ketë barazim pas 90-të minutave të lojës së rregullt do të ketë:

1. Shtesë 2x15 minuta
2. Penallti

Neni 20 - Fazat e garës

20.1 Abissnet Superiore do të zhvillohet në 4 (katër) faza përgjatë një sezoni.

20.2 Në të katër fazat do të zhvillohen ndeshje midis klubeve pjesëmarrëse me sistem vajtje-ardhje në përputhje me skemën e përcaktuar nga Neni 19.

20.3 Pas përfundimit të 4 fazave, skuadrat e renditura në vendin e 1 (parë), 2 (dytë), 3 (tretë) dhe të 4 (katertë) do të zhvillojnë ndeshje play off.

20.4 Ekipi i renditur në vendin e 1 (parë) të Final 4 do të shpallet Kampion i Kampionatit Kombëtar të Futbollit në "Abissnet Superiore"

Neni 21 - Klasifikimi

- 21.1 Klasifikimi në Abissnet Superiore bëhet përmes grumbullimit të pikëve sipas rregullit të mëposhtëm:
- Ekipi i cili fiton një ndeshje do të fitojë 3 (tre) pikë;
 - Ekipi i cili barazon një ndeshje do të fitojë 1 (një) pikë;
 - Ekipi i cili humb një ndeshje do të fitojë 0 (zero) pikë;
- 21.2. Rezultatet e ndeshjeve të zhvilluara regjistrohen dhe administrohen nga FSHF në mënyre të vazhdueshme përmes një table klasifikimi e cila duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për çdo ekip pjesëmarrës:
- Numrin e ndeshjeve të luajtura në sezonin përkatës;
 - Numrin e ndeshjeve të fituara/barazuara/humbura si ekip vendas;
 - Numrin e ndeshjeve të fituara/barazuara/humbura si ekip udhëtues;
 - Numrin e golave të shënuar/pësuar në sezonin përkatës;
 - Numrin e pikëve të grumbulluara në sezonin përkatës;
- 21.3 Klasifikimi i ekipeve në tabelën e klasifikimit do të përcaktohet sipas numrit të pikëve të grumbulluara gjatë sezonit, ku ekipi që ka grumbulluar më shumë pikë renditet në krye dhe ekipi që ka grumbulluar më pak pikë renditet në fund të klasifikimit.
- 21.4 Nëse dy ose më shumë ekipe kanë grumbulluar të njëjtën sasi pikësh, renditja e tyre në tabelën e klasifikimit përcaktohet duke mbajtur në konsideratë kriteret më poshtë:
- Pikët e grumbulluara në ndeshjet e zhvilluara midis ekipeve përkatëse;
 - Diferenca e golave të shënuar dhe të pësuar në ndeshjet e zhvilluara midis ekipeve përkatëse;
 - Diferenca e golave të shënuar dhe të pësuar gjatë Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Abissnet Superiore në sezonin përkatës;

- d. Numri më i madh i golave të shënuar gjatë Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Abissnet Superiore, sezoni futbollistik përkatëse;
- e. Me short;

Neni 22 - Fituesi i “Abissnet Superiore”

22.1. Klubi i cili, në përfundim të sezonit përkatës, renditet në vendin e 1 (parë) “Final 4”, shpallet Kampion i Kampionatit Kombëtar të Futbollit në “Abissnet Superiore”

Neni 23 - Rënia nga dhe ngritja në “Abissnet Superiore”

23.1 Në përfundim të sezonit përkatës, klubi i renditur përkatësisht në vendin e 9 (nëntë) dhe të 10 (dhjetë) bie menjëherë nga Abissnet Superiore, në Kategorinë e Parë.

23.2 Klubi i renditur në vendin e 1 (parë) dhe të 2 (dytë) të Kategorisë së Parë ngjiten menjëherë në Abissnet Superiore.

23.3 Ekipe të “A” dhe “B” nuk lejohen të luajnë në të njëjtën kategori.

23.4 Në rast se ekipi “A” për shkak të meritës sportive apo penalizimeve të mundshme nga organet disiplinore të FSHF-së, do të zbresë në të njëjtën kategori në të cilën ndodhet ekipi “B” atëherë automatikisht ekipi “B” zbritet në një kategori më poshtë.

23.5 Në rast se brenda të njëjtit sezon, ekipi “B”, me meritë sportive ngjitet në kategorinë nga e cila ka zbritur ekipi “A” atëherë ekipi “B” do të luajë në një kategori më lart se ekipi “A”.

Neni 24 - Ndeshja “Play-off” Abissnet Superiore

24.1 Në përfundim të sezonit përkatës, klubi i renditur në vendin e 8 (tetë) të Abissnet Superiore, do të zhvillojë një ndeshje me fituesin e ndeshjes “Play-off” midis klubeve të renditura në vendet e 3 (tretë), 4 (katërt), 5 (pestë) dhe të 6 (gjashtë) të “Kategorisë së Parë.

- 24.2 Ndeshja do të luhet në stadiumin e klubit të renditur në vendin e 8 (tetë) të Abissnet Superiore.
- 24.3 Fituesi i ndeshjes play-off, do të luajë në “Abissnet Superiore” në sezonin pasardhës.
- 24.4 Për këtë ndeshje, vlejné rregullat e parashikuara në nenin 28, pika a,b, c, d, e.
- 24.5 Në rast se renditja sportive sjell në përplasje në një ndeshje “Play-off” ekipet “A” dhe “B”, ekipit “B” do t’i hiqet e drejta për tu ngjitur sportivisht në Abissnet Superiore në sezonin përkatës dhe ndeshja “play-off” do të luhet midis klubit të renditur në vendin e 8 (tetë) të Abissnet Superiore dhe finalistit të ndeshjes “Play-off” midis klubeve të renditura në vendet e 3 (tretë),4 (katërt), 5 (pestë) dhe të 6 (gjashtë) të “Kategorisë së Parë.
- 24.6 Rregullat e parashikuara nga neni 23 vlejné edhe në rastet kur ekipi “A” renditet në vendin e 8 (tetë) të Abissnet Superiore ndërsa ekipi “B” në vendin e parë të “Kategorisë së Parë”.

III. KUPA E SHQIPËRISË

Neni 25 - Emërtimi i Garës

25.1. Gara emërtohet “Kupa e Shqipërisë” e shoqëruar nga sezoni futbollistik përkatës.

Neni 26 - Skema e “Kupës së Shqipërisë”

26.1. Kupa e Shqipërisë është e përberë nga dy faza: faza para-eliminatore dhe faza eliminatore.

26.2. Në fazën para-eliminatore do të marrin pjesë ekipet e renditura në vendin e 7, 8, 9 të Kategorisë së Dytë Grupi A të sezonit 2022-2023 si dhe vendet e 7, 8, 9, 10 të Kategorisë së Dytë Grupi B të sezonit 2022-2023 si dhe ekipi Kampion i Kategorisë së Tretë sezoni 2022-2023. Ndeshjet në këtë tur do të zhvillohem me një takim.

Për këto ndeshje, vlejnë rregullat e parashikuara në nenin 28 pika a,b,c, d, e.

26.3. Në fazën eliminatore do të marrin pjesë:

- a. 4 (katër) ekipet e kualifikuara nga faza para-eliminatore;
- b. 10 (dhjetë) ekipet e Abissnet Superiore sezoni 22/23
- c. 14 (katërbëmbëdhjetë) ekipet e Kategorisë së Parë sezoni 22/23;
- d. 6 (gjashtë) ekipet e renditura në vëndin e 1(parë), 2(dytë), 3(tretë),4 (katertë),5 (pestë) dhe të 6 (gjashtë) Kategoria e Dytë Grupi A sezoni 22/23;
- e. 6 (gjashtë) ekipet e renditura në vëndin e 1(parë), 2(dytë), 3(tretë),4 (katertë),5 (pestë) dhe të 6 (gjashtë) Kategoria e Dytë Grupi B sezoni 22/23;

- 26.4. Ndeshtjet e Turit 1/32, 1/16 dhe 1/8 do të zhvillohen me 1 (një) takim.
- 26.5 Ndeshtjet e Turit $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{1}{2}$ do të zhvillohen me 2 (dy) takime.
- 26.6 Për të gjitha ndeshjet e Kupës së Shqipërisë do të vlejnjë rregullat e parashikuara në nenin 28, pika a,b,c,d,e.
- 26.7 Ekipeve B nuk lejohen të marrin pjesë në Kupën e Shqipërisë.

Neni 27 - Kupa e Shqipërisë, Sezoni 2023-2024

- 27.1 Në sezonin 23/24 ndeshjet e turit 1/32,1/16 dhe 1/8 do të zhvillohen me një takim, ndërsa ndeshjet e turit $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{1}{2}$ do të zhvillohen me 2 (dy) takime. Rregulli i golit në fushën kundërshtare nuk është më i vlefshëm në rast se diferenca e golave është e njëjtë.
- a. Turi i Para para eliminator - Ndeshtjet
- Ekipeve i renditur në vendin e 7-të në Kat. II Grupi A do të ndeshet me ekipin kampion të Kategorisë së Tretë
 - Ekipeve i renditur në vendin e 8-të në Kat. II Grupi A do të ndeshet me ekipin i renditur në vendin e 9-të në Kat. II Grupi A
 - Ekipeve i renditur në vendin e 7-të në Kat. II Grupi B do të ndeshet me ekipin i renditur në vendin e 10-të në Kat. II Grupi B
 - Ekipeve i renditur në vendin e 8-të në Kat. II Grupi B do të ndeshet me ekipin i renditur në vendin e 9-të në Kat. II Grupi B
 - Për përcaktimin e ekipeve të listuara në vendet B13, B14, B15 dhe B16 do të hidhet short pas zhvillimit të turit paraeliminatar.
 - Në rast se gjatë ndeshjeve play out 22/23 ekipeve i Kategorisë së Dytë do të zbresi në Kategorinë e Tretë, vendin për të marrë pjesë në turin paraeliminatar të Kupës së Shqipërisë do ta përfitojë ekipeve i finalist i kategorisë së tretë.

b. Turi i Dyte 1/32

I.Ndarja e Ekipeve

Skema e ndeshjeve turi 1/32

Ekipi 1 (Vendas)			Ekipi 2 (Mik)		Çifti
A1	Superiore Vendi 9	vs	B16	Paraeleminator	C1
A2	Superiore Vendi 10	vs	B15	Paraeleminator	C2
A3	Kat I vendi 1	vs	B14	Paraeleminator	C3
A4	Kat I vendi 2	vs	B13	Paraeleminator	C4
A5	Kat I vendi 3	vs	B12	Kat. II, Gr. B, vendi 6	C5
A6	Kat I vendi 4	vs	B11	Kat. II, Gr. A, vendi 6	C6
A7	Kat I vendi 5	vs	B10	Kat. II, Gr. B, vendi 5	C7
A8	Kat I vendi 6	vs	B9	Kat. II, Gr. A, vendi 5	C8
A9	Kat I vendi 7	vs	B8	Kat. II, Gr. B, vendi 4	C9
A10	Kat I vendi 8	vs	B7	Kat. II, Gr. A, vendi 4	C10
A11	Kat I vendi 9	vs	B6	Kat. II, Gr. B, vendi 3	C11
A12	Kat I vendi 10	vs	B5	Kat. II, Gr. A, vendi 3	C12
A13	Kat I vendi 11	vs	B4	Kat. II, Gr. B, vendi 2	C13
A14	Kat I vendi 12	vs	B3	Kat. II, Gr. A, vendi 2	C14
A15	Kat I vendi 13	vs	B2	Kat. II, Gr. B, vendi 1	C15
A16	Kat I vendi 14	vs	B1	Kat. II, Gr. A, vendi 1	C16

c. Turi i Trete 1/16

Skema e ndeshjeve turi 1/16

Ekipi 1		Ekipi 2	Çifti
C1	vs	C16	D1
C2	vs	C15	D2
C3	vs	C14	D3
C4	vs	C13	D4
C5	vs	C12	D5
C6	vs	C11	D6
C7	vs	C10	D7
C8	vs	C9	D8

d. Turi i Katërt 1/8

Skema e ndeshjeve turi 1/8

Ekipi 1 (Vendas)		Ekipi 2 (Mik)	
S1	vs	D8	E 1
S2	vs	D7	E 2
S3	vs	D6	E 3
S4	vs	D5	E 4
S5	vs	D4	E 5
S6	vs	D3	E 6
S7	vs	D2	E 7
S8	vs	D1	E 8

- e. Turi i Pestë - Për përcaktimin e çifteve çerek finalistë hidhet short i lirë ndërmjet 8 (tetë) ekipeve të kualifikuara në këtë tur. Ekipeve të kualifikuara E1,E2,E3 dhe E4 do të jenë në vazon nr.1 ndërsa ekipeve të kualifikuara E5,E6,E7 dhe E8 do të jenë në vazon nr.2. Ndeshjet e para do të zhvillohen në fushën e ekipeve të pozicionuara në vazon nr.2. Ndeshjet luhen me sistem vajtje-ardhje, me dy takime.
- f. Turi i gjashtë - Për përcaktimin e çifteve gjysmë finalistë hidhet short i lirë ndërmjet 4 (katër) ekipeve të kualifikuara në këtë tur. Ndeshjet luhen me sistem vajtje-ardhje, me dy takime.
- g. Për të përcaktuar emertimin e ndeshjes finale të Kupës së Shqipërisë do të hidhet short i lirë. Stadiumi ku do të zhvillohet finalja e Kupës së Shqipërisë do të përcaktohet nga FSHF.

Neni 28 - Rregullat e kualifikimit

- 28.1 Përcaktimi i ekipit të futbollit i cili do të kualifikohet për turin pasardhës të Kupës së Shqipërisë ose për ndeshjet play off do të bëhet si më poshtë.
- a. në përfundim të ndeshjes së dytë, kualifikohet skuadra që ka grumbulluar më shumë pikë nga të dyja ndeshjet.
 - b. në rastet kur 2 (dy) skuadrat në fund të 90-të minutave të ndeshjes së parë ose të dytë të turit kanë rezultate të barabarta, për të nxjerrë skuadrën fituese, atëherë do të zhvillohen 2 x 15 minuta kohë shtesë.
 - c. në rast se dhe pas kohës shtesë kemi përsëri barazim, do të gjuhen 5 (pesë) goditje nga pika e penalltisë për secilën skuadër. Shpallet fitues ekipi që në përfundim të 5 gjuajtjeve të penalltive ka shënuar më shumë gola.
 - d. në rast se dhe pas gjuajtjeve të 5 goditjeve të penalltive kemi përsëri barazim, atëherë do të kemi goditje të alternuara nga pika e penalltisë deri në momentin që një njeri nga skuadrat nuk shënon.
 - e. shpallet fituese skuadra që shënon.

IV. SUPERKUPA E SHQIPËRISË

Neni 29 - Emërtimi i Garës

29.1 Gara emërtohet “Superkupa e Shqipërisë” e shoqëruar nga sezoni futbollistik përkatës.

Neni 30 - Rregullat e Kualifikimit

- 30.1 Superkupa e Shqipërisë luhet midis ekipeve kampione të “Abissnet Superiore dhe fituesit të “Kupës së Shqipërisë.
- 30.2 Ndeshja finale e Superkupës së Shqipërisë do të zhvillohet në një stadium të përcaktuar nga FSHF.
- 30.3 Në rast se një ekip, brenda sezonit shpallet njëkohësisht Kampion Kombëtar i Abissnet Superiore dhe fitues i Kupës së Shqipërisë, atëherë, Superkupa e Shqipërisë do të luhet midis ekipit kampion të Abissnet Superiore dhe ekipit finalist të Kupës së Shqipërisë.
- 30.4 Ekipi pritës në Superkupën e Shqipërisë do të jetë ekipi fitues i Kampionatit Kombëtar të Abissnet Superiore.
- 30.5 Për këtë ndeshje, vlejné rregullat e parashikuara ne nenin 28 pika a, b, c, d, e.

V. KALENDARI I GARËS

Neni 31 - Datat dhe oraret e ndeshjeve

31.1 Datat dhe oraret e zhvillimit të ndeshjeve do të përcaktohen nga FSHF përpara fillimit të sezonit përkatës. Kalendarit i ndeshjeve shpallet jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara fillimit të ndeshjes së parë zyrtare të sezonit dhe është i detyrueshëm për t`u zbatuar.

Neni 32 - Ndryshimi i datës dhe orës së ndeshjeve

32.1 FSHF ka të drejtë të ndryshojë datën dhe/ose orën e përcaktuar për zhvillimin e një ndeshje.

32.2 Klubet të cilat marrin pjesë në ndeshjet ndërkombëtare për klube të organizuara nga UEFA, mund të kërkojnë pranë FSHF ndryshimin e datës dhe/ose orës së ndeshjes së Kampionatit apo Kupës së Shqipërisë nëse kjo ndeshje është planifikuar për t`u luajtur brenda 3 (tre) ditëve të së njëjtës javë.

Neni 33 - Mbërritja e skuadrave

33.1 Skuadrat pjesëmarrëse duhet të paraqiten në stadiumin ku është parashikuar për t`u zhvilluar ndeshja të paktën 90 (nëntëdhjetë) minuta përpara orarit të përcaktuar për fillimin e ndeshjes.

Neni 34 - Shtyrja e ndeshjes

34.1 Nëse për shkaqe objektive zhvillimi i një ndeshje vihet në dyshim, ekipi pritës duhet menjëherë të njoftojë FSHF. Kjo e fundit, vendos nëse ndeshja duhet të zhvillohet sipas parashikimit apo duhen bërë ndryshime në datën, orën apo vendin. Këto vendime janë të formës së prerë.

- 34.2 Arbitri i ndeshjes vendos nëse një ndeshje nuk mund të fillojë ose një ndeshje që ka filluar duhet të ndërpritet. Ky vendim merret në konsultim me delegatin e FSHF-së dhe kur është e mundur edhe me administratën e FSHF-së.
- 34.3 Nëse njeri nga ekipet mbetet me më pak se 7 (shtatë) lojtarë, ndeshja nuk mund të vijojë dhe duhet të ndërpritet.
- 34.4 Në çdo rast, vendimet merren vetëm mbi bazën e këtij neni pa paragjykuar masa të mundshme disiplinore.

Neni 35 - Shtyrja ose riluajtja e ndeshjes

- 35.1 Nëse një ndeshje nuk mund të fillojë ose nuk mund të luhet plotësisht, ndeshja e plotë ose pjesa e mbetur do të luhet, si rregull ditën e nesërme pa paragjykuar masa të mundshme disiplinore.
- 35.2 Nëse një ndeshje nuk mund të ri luhet ditën e nesërme, FSHF do të përcaktojë një datë për ri luajtjen e sajë.
- 35.3 Si rregull, ndeshja do të ri luhet në të njëjtin stadium. Nëse për shkaqe objektive ndeshja nuk mund të zhvillohet në të njëjtin stadium, FSHF do të përcaktojë një stadium tjetër.
- 35.4 Në rrethana përjashtimore, për çështje tepër urgjente të cilat mund të ndikojnë në vijimin normal të garës, me qëllim garantimin e ri luajtjes së ndeshjes, ekipi pritës duhet të sigurojë një stadium alternativ të aprovuar nga FSHF.
- 35.5 Pa paragjykuar masa të mundshme disiplinore, klubi përgjegjës për shtyrjen ose ri luajtjen e ndeshjes do të mbulojë shpenzimet e nevojshme për klubin tjetër, arbitrat, vëzhguesin dhe delegatin e ndeshjes.
- 35.6 Nëse arbitri vendos të ndërpres një ndeshje e cila ka filluar, pjesa e mbetur duhet të luhet në respekt të parimeve të mëposhtme:
- a. Ndeshja do të rifillojë me listën e lojtarëve që ishin në fushën e lojës në momentin e ndërprerjes;

- b. Masat ndëshkimore (karton i verdhë dhe/ose karton i kuq) të dhëna përpara ndërprerjes së ndeshjes, mbeten të vlefshme për pjesën e mbetur të lojës.
- c. Masa ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) e dhënë përpara ndërprerjes së ndeshjes, nuk mbartet në ndeshje të tjera deri sa ndeshja e ndërprerë të përfundojë.
- d. Masa ndëshkimore me largim nga ndeshja (karton i kuq) e dhënë përpara ndërprerjes së ndeshjes, mbartet në ndeshjen pasardhëse. Lojtarët e larguar me karton të kuq, nuk mund të zëvendësohen dhe numri i lojtarëve në ndeshjen që ri luhet mbetet i njëjtë me atë që ishte në momentin e ndërprerjes.
- e. Ekipet mund të kryejnë vetëm zëvendësimet që u kishin mbetur në momentin e ndërprerjes së lojës.
- f. Ndeshja duhet të ri fillojë në të njëjtin pozicion loje në të cilin është ndërprerë.

Neni 36 - Refuzimi për të luajtur dhe situata të ngjashme

- 36.1 Nëse një klub refuzon të luajë, nuk paraqitet në stadium ose është përgjegjës për mos zhvillimin e një ndeshje plotësisht apo pjesërisht, në Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore, Komisioni i Disiplinës dhe Etikës së FSHF-së, përveç masave të tjera disiplinore, do të shpallë ndeshjen të humbur në tavolinë. Nëse refuzimi apo mos paraqitja ndodh në më shumë se 1 (një) ndeshje gjatë një sezoni, klubi përgjegjës do të përjashtohet nga gara dhe do të zbritet të paktën një kategori më poshtë duke iu zbritur jo më pak se 6 (gjashtë) pikë në sezonin pasardhës.
- 36.2 Nëse një klub refuzon të luajë, nuk paraqitet në stadium ose është përgjegjës për mos zhvillimin e një ndeshje plotësisht apo pjesërisht në Garën e Kupës së Shqipërisë, ekipi përgjegjës humbet ndeshjen në tavolinë, përjashtohet nga gara për sezonin aktual si dhe atë pasardhës.
- 36.3 Nëse një klub përjashtohet për ndonjë arsye apo tërhiqet nga gara

për Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore do të veprohet si më poshtë:

- a. Nëse përjashtimi ose tërheqja ndodh kur ekipi ka kryer më pak se 50% të ndeshjeve të planifikuara, do të shpallen të pavlefshme të gjitha pikët që ekipet e tjera kanë marrë në takimet direkte me të.
- b. Nëse përjashtimi ose tërheqja ndodh kur ekipi ka kryer 50% +1 ndeshje, pikët e grumbulluara gjatë ndeshjeve të zhvilluara, mbeten në fuqi. Ndeshjet e planifikuara për t'u zhvilluar sipas kalendarit në vazhdim do të jepen në tavolinë me rezultatin 3-0.

36.4 Nëse një klub i liçencuar, i cili për meritë sportive ka të drejtë të marrë pjesë në garë, tërhiqet përpara fillimit të saj për ndonjë arsye, do të zëvendësohet sipas parimeve të mëposhtme nga:

- a. Ekipi Finalist i play-off të Abissnet Superiore;
- b. Nëse ekipi finalist i play-off të Abissnet Superiore nuk liçencohet nga Komisioni i Liçensimit të Klubeve, vendin e tij do ta zërë ekipi finalist i *play-off* për vendet 3 (tretë), 4 (katërt), 5 (pestë) dhe të 6 (gjashtë) të "Kategorisë së Parë".
- c. Nëse ekipi përkatës i licensuar, nuk pranon të marrë pjesë në garë, ai do të zbritet 2 (dy) kategori më poshtë. Me qëllim ruajtjen e integritetit të garës, Komisioni i Disiplinës dhe Etikës mund të hetojë rrethanat e mos pjesëmarrjes.

36.5 Në çdo rast klubet që tërhiqen nga gara, humbasin çdo të drejtë për kompensim financiar nga FSHF.

VI. INFRASTRUKURA SPORTIVE

Neni 37 - Stadiumet

37.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, ndeshjet do të zhvillohen në një stadium i cili përmbush kriteret e Rregullores së Infrastrukturës së FSHF-së.

37.2 Për Kupën e Shqipërisë vlejnë minimalisht këto parashikime:

- a. Turi 1/16: Stadium i Kategorisë 1
- b. Turi 1/8: Stadium i Kategorisë 1
- c. Turi 1/4: Stadium i Kategorisë 2
- d. Turi 1/2: Stadium i Kategorisë 3

Neni 38 - Fusha e lojës

38.1 Klubi pritës duhet të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të garantuar që fusha e lojës të jetë në kushte sa më të përshtatshme. FSHF mund të kryejë inspektime në çdo kohë për të kontrolluar kushte të fushës së lojës.

38.2 Ehtë e ndaluar kryerja e seancave stërvitore në fushën e lojës të stadiumit përkatës gjatë sezonit futbollistik. Shkelja e kësaj dispozite, do të jetë subjekt i dënimeve nga Komisioni i Disiplinës dhe Etikës.

38.3 Si rregull, për fushat me bar natyral, lartësia e barit nuk mund të jetë më e lartë se 30 mm dhe e gjithë sipërfaqja e fushës duhet të jetë e prerë në të njëjtën lartësi. Nëse çmohet e arsyeshme nga arbitri ose delegati i FSHF, ekipit pritës mund t'i kërkohet të reduktohet lartësia e barit.

- 38.4 Fusha e lojës duhet të vaditet në mënyre uniforme. Si rregull, vaditja duhet të përfundojë 60 minuta përpara fillimit të ndeshjes. Përjashtimisht, klubi pritës mund të vadisë fushën e lojës me kusht që kjo të ndodhë:
- Maksimalisht 5 (pesë) minuta përpara fillimit të lojës;
 - Gjatë pushimit të lojës për maksimalisht 5 (pesë) minuta.
- 38.4 Portat duhet të instalohen në mënyre të sigurtë në përputhje me ligjet e lojës së IFAB.

Neni 39 - Fushat me bar artificial

- 39.1 Ndeshjet mund të zhvillohen në fusha me bar artificial me kusht që ato të përmbushin kriterin FIFA QUALITY PROGRAMME FOR FOOTBALL TURF.

Neni 40 - Sistemi i ndriçimit

- 40.1 Ndeshjet mund të zhvillohen me ndriçim artificial nëse sistemi i ndriçimit në stadiumin përkatës përmbush kriteret e Rregullores së Infrastrukturës së FSHF-së.
- 40.2 Klubet duhet të depozitojnë në FSHF një çertifikatë të vlefshme nga kompani të çertifikuara për testimin e sistemeve të ndriçimit.
- 40.3 FSHF mund të kryejë verifikime lidhur me sistemet e ndriçimit.

Neni 41 - Ora dhe ekranet ne stadium

- 41.1 Orët e stadiumit mund të përdoren për të shfaqur kohën e luajtur ose kohën mbetur të lojës me kusht që të ndalin në përfundim të kohës së rregullt të secilës pjesë loje. Ky parashikim vlen edhe për kohën shtesë.
- 41.2 Rezultati i ndeshjes apo ndeshjeve të tjera mund të shfaqet në ekranet gjigande të stadiumeve.
- 41.3 Klubet pritëse nuk mund të transmetojnë ndeshjen ose rastet e ndeshjes në ekran.

41.4 Klubet pritëse duhet të garantojnë që pamjet e transmetuara në ekran:

- a. Të mos kenë ndikim në ndeshje;
- b. Të mos provokojnë incidente mbi ekipet apo spektatorët;
- c. Të mos çënojnë rendin publik;
- d. Të mos çënojnë imazhin, reputacionin dhe autoritetin e ndonjë lojtari, arbitri, zyrtari apo te FSHF;

41.5. Delegati i FSHF-së mund të kërkojë që ekranet të përdoren vetëm për shfaqen e rezultateve të ndeshjeve.

Neni 42 - Ora diellore e ndeshjeve

Tabela orientuese e orarit diellor si më poshtë:

MUAJI	Ora	MUAJI	Ora
JANAR	14:00	KORRIK	17:00
SHKURT	14:00	GUSHT	17:00
MARS	15:00	SHTATOR	16:00
PRILL	16:00	TETOR	14:00
MAJ	17:00	NENTOR	14:00
QERSHOR	17:00	DHJETOR	14:00

VII. ORGANIZIMI I NDESHJEVE

Neni 43 - Pajisjet e ndeshjes

- 43.1 Në të gjitha aktivitetet e FSHF-së përdoret vetëm topi zyrtar i liçencuar nga FSHF në përputhje me Ligjet e Lojës së IFAB.
- 43.2 Klubi pritës duhet t'i vendosë në dispozicion ekipit udhëtues 10 (dhjetë) topa të njëjtë me ato të lojës për sesionet e nxemjes përpara ndeshjes.
- 43.3 Klubi pritës duhet të jetë i pajisur me dy tabela zëvendësimesh, mundësisht elektronike.
- 43.4 *Goal Line Technology (GLT)* mund të përdoret në përputhje me Ligjet e Lojës së IFAB në ndeshjet zyrtare me qëllim asistimin e arbitrit për verifikimin e shënimit të golit. Ky vendim mbetet tagër vetëm i arbitrit dhe është i formës së prerë. Dëmtimi apo mos funksionimi i GLT nuk mund të paragjykojë vendimin e arbitrit. Nëse është e nevojshme, ndeshjet do të zhvillohen pa GLT. Çdo klub pjesëmarrës në Garë autorizon FSHF dhe subjektet e autorizuar nga FSHF për të instaluar sistemet e liçensuara në stadiumin përkatës si dhe t'i sigurojë FSHF akses në çdo kohë lidhur me sistemin. Klubi në stadiumin e të cilit është instaluar GLT duhet të garantojë paprekshmërinë e GLT nga palë të treta.
- 43.5 Protokolli Video Assistant Referee "VAR" do të përdoret në ndeshjet zyrtare të kampionatit "Abissnet Superiore", në ndeshjet e turit çerekfinal e në vijim të "Kupës së Shqipërisë" dhe në raste specifike VAR mund të aplikohet në të gjitha ndeshjet e kampionateve të tjera Shqiptare, në përputhje me Ligjet e Lojës së IFAB me qëllim asistimin e arbitrit për rastet e gabimeve të dukshme. Dëmtimi apo mos funksionimi i VAR nuk mund të paragjykojë vendimin e arbitrit. Çdo klub pjesëmarrës në Garë

autorizon FSHF dhe subjektet e autorizuar nga FSHF për të instaluar sistemet e licensuara në stadiumin përkatës si dhe t'i sigurojë FSHF akses në çdo kohë lidhur me sistemin. Klubi në stadiumin e të cilit është instaluar VAR duhet të garantojë paprekshmërinë e zyrtareve që zbatojnë protokollin VAR nga palë të treta. Dështimi në zbatimin e këtij neni do të jetë objekt i Komisionit të Disiplinës dhe Etikës.

Neni 44 - Stërvitja përpara ndeshjes

44.1 45 minuta përpara fillimit të ndeshjes, nëse kushtet e fushës së lojës e lejojnë, ekipi udhëtues duhet të lejohet të kryejë një seancë stërvitore.

Neni 45 - Deklarimi i biletave

45.1 Klubet pritëse duhet të vendosin në dispozicion të spektatorëve udhëtues të paktën 5% të kapacitetit total të aprovuar nga FSHF për stadiumin përkatës, në një pozicion të veçuar dhe të sigurtë.

45.2 Përveç sa më sipër, Klubet pritëse duhet të vendosin në shitje bileta të kategorisë më të lartë për spektatorët VIP të ekipit udhëtues pa qenë ky i fundit i detyruar për t'i blerë të gjitha.

45.3 Zyrtarët e FSHF-së dhe të paktën 20 përfaqësues të Klubit udhëtues duhet të pajisen me bileta VIP nga Klubet pritëse.

45.4 Klubet pjesëmarrëse mund të dakordësojnë me marrëveshje çështjet e biletave duke njoftuar paraprakisht me shkrim FSHF.

45.5 Klubet janë të detyruara të vendosin çmim të njëjtë biletash si për tifozët vendas ashtu edhe për tifozët e ekipit udhëtues në sektorë të njëjtë në stadium.

45.6 Klubeve pjesëmarrëse në ndeshjet e "Final 4" do t'u garantohet një shpërndarje e barabartë e biletave. Komiteti Ekzekutiv i FSHF do të vendosë në kohën e duhur, mbi mënyrën e shpërndarjes dhe çmimet e biletave.

VIII. PROÇEDURAT E NDESHJEVE

Neni 46 - Formulari i ekipeve

- 46.1 Të paktën 60 minuta përpara ndeshjes, secili ekip duhet të listojë në formularin përkatës numrin e fanellës, emrin dhe mbiemrin për 21 lojtarë si dhe emrat, mbiemrat dhe detyrat për 7 zyrtarë që do të qëndrojnë në stolin e rezervave. Formulari duhet të përmbajë gjithashtu informacionin e nevojshëm për ngjyrat e fanellave të secilit ekip, përfshirë edhe uniformën e portierit.
- 46.2 11 Lojtarët e listuar në formularin e ekipit duhet të fillojnë ndeshjen si titullar. Lojtarët e tjerë listohen si zëvendësues. Numrat në fanellat e lojtarëve duhet të përputhen me numrin në formular, ku portieri dhe kapiteni duhet gjithashtu të identifikohen.
- 46.3 Vetëm 5 nga lojtaret e listuar si zëvendësues mund të luajnë. Një lojtar i cili është zëvendësuar nuk mund të luajë. Përrjashtimisht në ndeshjet e Kupës së Shqipërisë, gjatë kohës shtesë lejohen të kryhet edhe 1 zëvendësim shtesë (gjithsej 6 zëvendësime)
- 46.4 Pas dorëzimit të formularit dhe përpara fillimit të lojës, ekipet nuk mund të kryejnë zëvendësime me përjashtim të rasteve të mëposhtme:
- Nëse ndonjë nga 11 lojtarët e listuar në formular si titullar e ka të pamundur të luajë për shkak të gjendjes së papërshtatshme fizike, ai mund të pezulluarhet nga njëri prej lojtarëve të listuar si zëvendësues në formularin e ekipit. Gjate ndeshjes, mund të kryhen 5 zëvendësime në përputhje me ligjet e lojës së IFAB.
 - Nëse ndonjë nga lojtarët e listuar në formular si zëvendësues e ka të pamundur të luajë për shkak të gjendjes së papërshtatshme fizike, ai mund të zëvendësohet nga një

lojtar i regjistruar i cili nuk ishte listuar në formularin fillestar.

- c. Nëse asnjëri prej portierëve të listuar në formularin e ekipeve nuk mund të luajë për shkak të gjendjes së papërshtatshme fizike, ai mund të zëvendësohet nga një portier i regjistruar i cili nuk ishte listuar në formularin fillestar.

Në çdo rast ekipi përkatës duhet t'i paraqesë Delegatit të FSHF-së certifikatat mjekësore të nevojshme.

Neni 47 - Aspekte protokollare të ndeshjes

- 47.1 Emërtimi “Abissnet Superiore” ose “Kupa e Shqipërisë” si dhe stema e përkatëse duhet të vendoset në qendër të paneleve apo sistemit të reklamave, në linjën përgjatë fushës, përballë me tribunën kryesore ose pozicionet e prodhimit televiziv.
- 47.2 Flamuri i FSHF duhet të vendoset në stadium në çdo ndeshje zyrtare. Ai u dorëzohet klubeve nga administrata e FSHF-së.
- 47.3 Të dy ekipet duhet të paraqiten në stadiumin përkatës 90 minuta përpara fillimit të lojës.
- 47.4 Në çdo ndeshje, lojtarët janë të ftuar t'u japin dorën kundërshtarëve dhe ekipit të arbitrave gjatë ceremonisë së rreshtimit në shenjë fair-play.
- 47.5 FSHF rezervon të drejtën për të vendosur materiale promocionale për të zhvilluar imazhin e garës.
- 47.6 Klubet duhet të njoftojnë paraprakisht me shkrim FSHF-në të paktën 24 orë përpara fillimit të ndeshjes lidhur me çdo ceremoni apo aktivitet, të tilla si veshja e bluzave me mesazhe sensibilizuese, mbajtja e një minute heshtje, shpalosja e parullave të caktuara nga tifozeria etj. FSHF rezervon të drejtën të miratojë ose jo, kërkesat e klubeve.

Neni 48 - Zona teknike dhe stoli i rezervave

- 48.1 Në stolin e rezervave mund të qëndrojnë vetëm 10 (dhjetë) lojtarë të listuar si zëvendësues dhe 7 (shtatë) zyrtarë të ekipit, nga të cilët njëri duhet të jetë mjek. Emrat e personave dhe funksionet e tyre duhet të listohen në formularin e ndeshjes.
- 48.2 Në afërsi të zonës teknike mund të qëndrojnë 7 (shtatë) persona si staf teknik i ekipit. Ndenjëset e tyre duhet të jenë jashtë zonës teknike dhe duhet të kenë akses dhomat e zhveshjes. Emrat e personave dhe funksionet e tyre duhet të listohen në formularin e ndeshjes.
- 48.3 Gjatë ndeshjes, lojtarët zëvendësues lejohen të largohen nga zona teknike për të kryer nxemjen. Arbitri vendos vendin se ku ata mund të kryejnë nxemjen dhe numrin e zëvendësuesve që mund të kryejnë nxemjen njëkohësisht.
- 48.4 Tymosja e duhanit nuk lejohet në zonën teknike përgjatë ndeshjes.
- 48.5 Përdorimi i pajisjeve të telekomunikacionit rregullohet në përputhje me ligjet e lojës së IFAB.
- 48.6 Përveç se kur vendoset ndryshe nga FSHF, si rregull i përgjithshëm, ekipi vendas do të qëndrojë në stolin e rezervave i cili ndodhet në krahun e majtë të fushës së lojës ndërsa ekipi udhëtues do të qëndrojë në stolin e rezervave i cili ndodhet në krahun e djathtë të fushës së lojës.

IX. REGJISTRIMI I LOJTARËVE DHE ZYRTARËVE

Neni 49 - Kriteret për regjistrimin e lojtarëve

- 49.1 Për të luajtur në ndeshje zyrtare, lojtari duhet të jetë i regjistruar pranë FSHF ose ndonjë federate tjetër anëtare të FIFA në përputhje me Rregulloren për Statusin dhe Transferimin e Lojtarëve të FSHF.
- 49.2 Çdo lojtar pjesëmarrës në ndeshje zyrtare duhet të jetë i pajisur me kartën e federimit lëshuar nga FSHF si dhe dokument të vlefshëm identifikimi si letërnjoftim ID ose Pasaportë. Arbitri i ndeshjes ka të drejtë t'i kërkojë lojtarit dokumentin e identifikimit.
- 49.3 Të gjithë lojtarët duhet t'i nënshtrohen ekzaminimeve mjekësorë.
- 49.4 Klubet janë përgjegjëse për pasojat ligjore dhe disiplinore që mund të vijnë nga aktivizimi i lojtarëve të peregjistruar.
- 49.5 Administrata e FSHF vendos lidhur me çështjet e provueshmërisë së lojtarëve.

Neni 50 - Lista e lojtarëve

- 50.1 Klubet janë përgjegjës për dorëzimin në FSHF të listës së lojtarëve të ekipit të parë dhe të dytë. Këto lista duhet të përmbajnë të dhënat për emrin, mbiemrin, datëlindjen, numrin e fanellës, kombësinë dhe shtetësinë e të gjithë lojtarëve që do të aktivizohen në garë bashkë me emrin e mbiemrin e trajnerit të parë. Listat duhet të shoqërohen me konfirmimin nga mjeku i ekipit se të gjithë lojtarët kanë kryer ekzaminimet mjekësorë të nevojshme. Mjeku i ekipit mban përgjegjësi për garantimin e kryerjes së ekzaminimeve nga lojtarët e klubit.

- 50.2 Gjatë një sezoni futbollistik, klubet mund të regjistrojnë maksimalisht 25 lojtarë, nga të cilët, të paktën 8 lojtarë duhet të jenë të trajnuar në klub ose në FSHF. Kombinimet e mundshme të listës së lojtarëve parashikohen në Aneksin Nr.4.
- 50.3 Me lojtar të trajnuar në klub ose në FSHF do të kuptohet një lojtar i cili nga mosha 15 vjeçare (ose nga fillimi i sezonit gjatë të cilit mbush këtë moshë) deri në moshën 21 vjeçare, ka qenë i regjistruar me klubin aktual për një periudhë prej tre sezonesh (në mënyrë të vazhdueshme ose jo).
- 50.4 Lista e lojtarëve duhet të depozitohet në FSHF brenda orës 24:00 të ditës në të cilën mbyllet regjistrimet e periudhës përkatëse të transferimit. Lista duhet të jetë e shoqëruar me kontratën standarde (sipas Aneksit Nr.5) të nënshkruar nga të dyja palët në secilën faqe dhe vërtetimin mjekësor përkatës.

Neni 51 - Aktivizimi i lojtarëve

- 51.1 Gjatë një ndeshje zyrtare nuk mund të aktivizohen njëkohësisht në fushën e lojës më shumë se 5 (pesë) lojtarë të huaj.
- 51.2 Me lojtar të huaj do të kuptohet një lojtar i cili ka shtetësi të ndryshme përveç asaj të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës apo Maqedonisë së Veriut.
- 51.3 Përrjashtimisht, FSHF mund të marrë në shqyrtim raste të lojtarëve me shtetësi të ndryshme, përveç asaj të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës apo Maqedonisë së Veriut, nëse bazuar në prova shkresore, vërtetohet kombësia Shqiptare e lojtarit.
- 51.4 Lojtari i cili nuk ka mbushur moshën 16 (gjashhtëmbëdhjetë) vjeç, nuk lejohet të luajë me ekipin e parë të asnjë klubi pjesëmarrës në kampionatet ose garat e organizuara nga FSHF.
- 51.5 Një lojtar në proces gjykimi në Organet Juridike të FSHF-së mund të regjistrohet nga një klub në listën e federimit COMET, por pa patur të drejtën e aktivizimit deri në momentin e marrjes së një vendimi përfundimtar nga Organet përkatëse.

- 51.6 Një lojtar mund të federohet në emër të një klubi që merr pjesë në Abissnet Superiore, ose U-21, Kategorinë e Parë, vetëm si lojtar profesionist.
- 51.7 Një lojtar gjatë sezonit futbollistik mund të regjistrohet deri në 3 (tre) klube, por mund të aktivizohet deri në 2 (dy) klube.
- 51.8 Lojtari në Kupën e Shqipërisë mund të aktivizohet me më shumë se 1 (një) ekip gjatë një sezoni futbollistik.
- 51.9 Lojtarët e ekipeve të moshave, që janë të regjistruar në FSHF, kanë të drejtë të aktivizohen me të rriturit e klubit të tyre.
- 51.10 Lojtarët e federuar me ekipet e moshave të një klubi të cilët aktivizohen në fushën e lojës në ndeshjet e Kampionatit përkatës, kanë të drejtë aktivizimi në ekipin e të rriturve vetëm pas 48 orëve nga ndeshja e fundit.
- 51.11 Në rastet kur një lojtar i ekipit të moshave U-17, U-19 dhe U-21 është i pezulluar për një ndeshje si pasojë e 4 (katër) kartonave të verdhë në Kampionatin ku luan, ka të drejtë të luajë me ekipin e Parë në Kampionatin e Kategorisë përkatëse.
- 51.12 Lojtari që aktivizohet në kampionatin e moshave, kur ka masa disiplinore nuk ka të drejtë të aktivizohet me ekipin e të rriturve derisa të shlyej masën disiplinore.
- 51.13 Lojtari i ndëshkuar me masë disiplinore nga Komisionet Juridike të FSHF-së, e shlyen dënimin në vazhdimësi Kampionatin ku merr pjesë, në Kupën e Shqipërisë si dhe në Superkupë.
- 51.14 Lojtari do t'i kryej të veçuara dënimet e marra në Kampionatin përkatës nga ato në Kupë për Karton të Verdhë dhe Karton të Kuq.
- 51.15 5 (pesë) lojtarë të federuar me ekipin "A" të një klubi të cilët aktivizohen në fushën e lojës në ndeshjet e Kampionatit përkatës, kanë të drejtë aktivizimi në ekipin "B" vetëm pas 48 orëve nga ndeshja e fundit.
- 51.16 2 (dy) lojtarë të federuar me ekipin "B" të një klubi të cilët aktivizohen në fushën e lojës në ndeshjet e Kampionatit përkatës, kanë të drejtë aktivizimi në ekipin "A" vetëm pas 48 orëve nga ndeshja e fundit.

Neni 52 - Trofeu “Lojtari më i mirë i vitit”

- 52.1 Trofeu “Lojtari më i mirë i vitit” për Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore akordohet nga FSHF për lojtarin i cili merr më shumë vlerësime sipas parashikimeve të kësaj rregullore. Fituesit i dorëzohet përmes një ceremonie zyrtare “Topi i Artë” dhe një shume prej 200.000 (dyqindmijë) lekësh.
- 52.2 “Topi i Artë” modelohet dhe prodhohet në metal të zakonshëm dhe lahet në metal të çmuar, ar dhe argjend në edicione një vjeçare.
- 52.3 Trofeu “Topi i Artë” akordohet duke ndjekur procedurën në vijim:
- a. Klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore depozitojnë në FSHF brenda datës 10 Dhjetor një propozim me emrat e 3 (tre) lojtarëve;
 - b. FSHF harton një listë me 10 (dhjetë) lojtarët të cilët kanë marrë më shumë propozime.
 - c. Lista e lojtarëve publikohet gjatë ceremonisë zyrtare.
- 52.4 “Topi i Artë” është pronë e lojtarit të cilit i akordohet trofeu.

Neni 53 - Trofeu “Golashënuesi më i mirë”, Abissnet Superiore

- 53.1 Trofeu “Golashënuesi më i mirë”, për Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore do të akordohet nga FSHF për lojtarin që ka shënuar më shumë gola në ndeshjet zyrtare të Kategorisë Superiore, nga të gjithë lojtarët e tjerë, pavarësisht nga klubi ku ishte i federuar, shpallet golashënuesi më i mirë. Fituesit i dorëzohet përmes një ceremonie zyrtare Trofeu “Golashënuesi më i mirë” dhe një shumë 200,000 (dyqind mijë) lekë.
- 53.2 “Këpuca e Artë”; modelohet dhe prodhohet në metal të zakonshëm dhe lahet në metal të çmuar, ar dhe argjendë në edicione një vjeçare.
- Trofeu “Golashënuesi më i mirë”, për Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore akordohet duke ndjekur procedurën në vijim:

- a. lojtari që në përfundim të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, Abissnet Superiore, ka shënuar më shumë gola në ndeshjet zyrtare të Abissnet Superiore, nga të gjithë lojtarët e tjerë, pavarësisht nga klubi ku ishte i federuar, shpallet golashënuesi më i mirë i garës dhe përfiton trofeun “Këpuca e Artë”;
- b. nëse në përfundim të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, Abissnet Superiore, rezultojnë dy ose më shumë lojtarë të cilët përmbushin përcaktimet e pikës (a) këtu më sipër në këtë paragraf, atëherë për të përcaktuar golashënuesin më të mirë zbatohen kriteret në vijim:
 - i. golashënuesi më i mirë është lojtari që ka raportin (gola të shënuar gjithsej) për mbi (ndeshje të luajtura gjithsej) në sezonin përkatës, më të madh;
 - ii. golashënuesi më i mirë është lojtari që ka raportin (gola të shënuar gjithsej) për mbi (minuta të luajtura gjithsej) në sezonin përkatës, më të madh;
 - iii. nëse edhe pas zbatimit të kriteve më sipër këtu në këtë pikë (b), rezultojnë dy ose më shumë lojtarë të cilët përmbushin përcaktimet e pikës (a) këtu më sipër në këtë paragraf, atëherë për të përcaktuar golashënuesin më të mirë FSHF do të hedhë short për të shpallur golashënuesin më të mirë të sezonit futbollistik përkatës.
- c. “Këpuca e Artë” mbetet pronë e lojtarit i cili e përfiton këtë trofe në zbatim të pikës (a) këtu më sipër në këtë paragraf, përveç rastit të zbatimit të sanksioneve me zbrapsje të trofeve ndaj lojtarit përkatës, siç përcaktohet në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së;

X. ARBITRIMI

Neni 54 - Emërimi dhe zëvendësimi i arbitrave

- 54.1 Për Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore, zbatohen Ligjet e Lojës së IFAB lidhur me arbitrat.
- 54.2 Skuadra e arbitrimit përbëhet nga arbitri kryesor, dy asistentë, arbitri i katërt si dhe arbitrat Var dhe Avar.
- 54.3 Departamenti i Arbitrimit në FSHF përcakton arbitrat për secilën ndeshje. Ata mund të jenë Shqiptar ose të huaj.
- 54.4 FSHF merr masat e nevojshme që arbitrat të paraqiten në stadiumin përkatës 90 (nëntëdhjetë) minuta përpara fillimit të ndeshjes.
- 54.5 Në rast se një arbitër ose asistent, e ka të pamundur për të ushtruar detyrën ai/ajo zëvendësohet nga një tjetër anëtar i skuadrës së arbitrimit.
- 54.6 Në rast se gjatë ndeshjes do të ketë mos funksionim të sistemin VAR, delegati i FSHF duhet të njoftojë përfaqësuesit e të dy ekipeve.
- 54.7 Arbitri i ndeshjes duhet të plotësojë protokollin e ndeshjes në sistemin COMET, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas përfundimit të ndeshjes përkatëse.
- 54.8 Arbitrat e huaj:
- Në raste të veçanta, kur FSHF e sheh të arsyeshme, vendos që një ndeshje duhet të gjykohet nga arbitra të huaj.
 - Kërkesa për arbitra të huaj duhet të depozitohet në FSHF jo më pak se 10 (dhjetë) ditë nga data e zhvillimit të ndeshjes përkatëse.
 - Në rast se klubit të interesuar për arbitra të huaj i është miratuar kërkesa nga FSHF, klubi duhet të depozitojë në llogarinë bankare të FSHF-së shumën e nevojshme.

XI. ÇËSHTJE DISIPLINORE

Neni 55 - Kodi i Disiplinës Sportive

55.1 Parashikimet e Kodit të Disiplinës Sportive të FSHF-së aplikohen për të gjitha shkeljet disiplinore të kryera nga klubet, zyrtarët, lojtarët apo çdo individ që ushtron një funksion gjatë një ndeshje në emër të klubit përkatës.

Neni 56 - Kartonat

- 56.1 Si rregull, lojtari i cili largohet nga fusha e lojës me masë ndëshkimore nuk luan në ndeshjen pasardhëse të së njëjtës gare. Në rast të shkeljeve më të rënda, Komisioni i Disiplinës dhe Etikës pranë FSHF-së ka të drejtë të ndërmarrë masa në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive.
- 56.2 Lojtari ose zyrtari i cili gjatë garës merr 4 (katër) masa ndëshkimore paralajmëruese me karton të verdhë, nuk mund të luajë ose të qëndrojë në pankinë në ndeshjen pasardhëse të së njëjtës garë.
- 56.3 Kartonët e verdhë individual mbarten në Kampionatin e Kategorisë përkatëse.
- 56.4 Kur lojtari i cili ka plotësuar numrin e 4 (katër) kartonave të verdhë dhe njëkohësisht është ndëshkuar me masë disiplinore nga Komisionet Juridike të FSHF-së, filimisht do të shlyej dënimin e kartonave të verdhë dhe më pas pezullimin nga vendimet e Komisioneve Juridike.
- 56.5 Në Kupën e Shqipërisë, lojtari që plotëson numrin 4 (katër) të kartonave të verdhë të marrë, nuk luan një ndeshje në garën përkatëse.

- 56.6 Lojtari do t'i kryej të veçuara dënimet e marra në Kampionatin përkatës nga ato në Kupë për Karton të Verdhë dhe Karton të Kuq.
- 56.7 Kur lojtari ka kartona të verdhë të mbartura, dhe gjatë një ndeshje ndëshkohet me karton të kuq, kryerja e dënimit për kartonin e kuq, nuk eliminon kartonat e verdhë të mbartura.
- 56.8 Kur lojtari gjatë ndeshjes ndëshkohet me karton të verdhë dhe më pas ndëshkohet me karton të kuq, kartoni i verdhë do të mbartet.
- 56.9 Kur lojtari gjatë ndeshjes ndëshkohet me 2 (dy) kartona të verdhë që rezultojnë në një karton të kuq, kartonat e verdhë nuk do të mbarten.
- 56.10 Kur lojtari merr një karton të kuq, nuk luan në ndeshjen pasardhëse.
- 56.11 Kur lojtari pezullohet me masë disiplinore nga Komisionet Juridike të FSHF-së, pezullimi mbartet edhe për sezonin e ardhshëm.
- 56.10 Kartonat e verdhë të akumuluar në Kupën e Shqipërisë nuk do të mbarten në ndeshjen finale të kësaj gare.
- 56.11 Kartonat e verdhë të akumuluar gjatë Kampionatit Kombëtar të Abissnet Superiore nuk do të mbarten në ndeshjet Final 4.
- 56.12 Kartonat e kuq (teknik) në ndeshjen e fundit të Kampionatit Kombëtar të Abissnet Superiore nuk do të mbarten në ndeshjet Final 4.
- 56.13 Lojtarët/zyrtarët e dënuar me vendim të Komisionit të Disiplinës nuk kanë të drejtë të aktivizohen në Final 4.
- 56.14 Kartonat e verdhë të akumuluar në Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore nuk do të mbarten në ndeshjet play-off.

Neni 57 - Reklamimet

- 57.1 Klubet kanë të drejtë të reklamojnë probleme që lidhen me rezultatin e ndeshjes, në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive.

Neni 58 - Zhvillimi i ndeshjes pa spektatorë

58.1 Ndeshjet të cilat janë sanksionuar të luhen pa spektatorë, do të zhvillohen në përputhje me përcaktimet si më poshtë:

- a) brenda rrethimit të stadiumit nuk duhet të hyjë dhe/ose të qëndrojë asnjë person që nuk është zyrtar i klubeve pjesëmarrëse, zyrtar i ndeshjes, përfaqësues i autorizuar i FSHF-së, punonjës i policisë së shtetit, ose punonjës përgjegjës për ruajtjen e sigurisë në stadium;
- b) në tribunën VIP të stadiumit mund të qëndrojnë vetëm nga 10 (dhjetë) zyrtarë ose persona VIP, për secilin nga klubet pjesëmarrëse në ndeshjen përkatëse;
- c) portat e hyrjes për në tribunat e stadiumit duhet të jenë të mbyllura.

Neni 59 - Lojtarët, trajnerët dhe zyrtarët e pezulluar

59.1 Lojtarët, trajnerët ose zyrtarët të cilët janë sanksionuar me pezullim nga ndeshjet zyrtare, ose me përjashtim nga pjesëmarrja në garë, janë rreptësisht të ndaluar të marrin pjesë në ndonjë ndeshje zyrtare gjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të sanksionit përkatës, përfshirë këtu:

- a. janë rreptësisht të ndaluar të udhëtojnë së bashku me ekipin;
- b. janë rreptësisht të ndaluar të hyjnë ose të qëndrojnë në ambjentet e brendshme të stadiumit, në dhomën e zhveshjes, në fushën e lojës, dhe/ose në stolin e rezervave;

59.2 Lojtarët, trajnerët ose zyrtarët të cilët shkelin përcaktimet në paragrafin (1), këtu më sipër në këtë nen, do të sanksionohen me gjobë me një vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me pezullim nga ndeshja për 2 (dy) ndeshje.

XII. UNIFORMAT E LOJËS

Neni 60 - Aprovimi i uniformave

- 60.1 Me përjashtim ku parashikohet ndryshe, për këtë rregullore gjejnë zbatim parashikimet e UEFA *Kit/Equipment Regulations*.
- 60.2 Çdo klub duhet të depozitojë në FSHF formularin e aprovimit të uniformave bashkë me formularin e regjistrimit në garë përpara fillimit të sezonit përkatës. Uniformat duhet të jenë tre, të ndryshme për ndeshjet pritëse dhe ato në transfertë.

Neni 61 - Ngjyrat

- 61.1 Për të gjitha ndeshjet zyrtare, klubi pritës ka të drejtën e zgjedhjes së uniformës me të cilën do të luajë ndeshjet pritëse.
- 61.2 Në çdo rast kur arbitri i ndeshjes verën se ngjyrat e uniformave të dy ekipeve janë të ngjashme dhe mund të krijojnë konfuzion, ai vendos duke u konsultuar me delegatin e FSHF-së. Si rregull, në këto raste ekipi pritës duhet të ndryshojë uniformat për arsye praktike.

Neni 62 - Numrat dhe emrat

- 62.1 Përgjatë gjithë sezonit futbollistik, lojtarët e një klubi duhet të mbajnë të njëjtin numër në uniformën e lojës (në fanellë dhe në pantallona). Numri në uniforme mund të jetë nga 1 - 99. Nëse numri 1 përdoret, ai duhet të mbahet vetëm nga portieri.

Neni 63 - Sponsorët në fanellë

- 63.1 Vetëm sponsorët e aprovuar nga FSHF mund të vendosen në fanellën e lojës.
- 63.2 Klubet mund të ndryshojnë sponsorët në fanellë gjatë sezonit vetëm një herë gjatë një sezoni.
- 63.3 Fillimi i sezonit pa një sponsor në fanellë nuk konsiderohet ndryshim.
- 63.4 Ndryshimi i përmbajtjes (formës/logos) ndonëse sponsori është i njëjtë do të konsiderohet ndryshim.
- 63.5 Klubet të cilat kërkojnë të ndryshojnë sponsorin në fanellë duhet të depozitojnë në FSHF kërkesën të paktën 7 (shtatë) ditë përpara ndeshjes gjatë të cilës dëshirojnë të shfaqin sponsorin e ri.
- 63.6 Parashikimet e këtij neni vlejnë edhe për sponsorët ose reklamat në uniformat e stërvitjes.

Neni 64 - Stemat

- 64.1 Përgjatë gjithë ndeshjeve zyrtare, stema e Abissnet Superiore duhet të shfaqet në mëngën e djathtë të fanellës së lojës.

XIII. ÇËSHTJE FINANCIARE

Neni 65 - Shpërblimet nga FSHF

- 65.1 Shpërblimet financiare të paguara nga FSHF shprehen në vlerë neto.
- 65.2 Shpërblimet financiare të paguara nga FSHF kryhen në LEK/EUR dhe paguhen në llogarinë bankare të klubit pjesëmarrës.
- 65.3 Me përjashtim të FSHF-së, klubet nuk mund të transferojnë të drejtën e shpërblimeve financiare tek një palë e tretë.

Neni 66 - Detyrimet financiare për pjesëmarrje në garë

- 66.1 Klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore, detyrohet të paguajë detyrimet e mëposhtme financiare:
- 1000 (njëmijë) Lek për çdo karton federimit;
 - 1000 (njëmijë) Lek për çdo karton të verdhë, shumë e cila duhet paguar brenda 30 ditëve;
 - 5000 (pesëmijë) lek për çdo karton të kuq, shumë e cila duhet paguar brenda 30 ditëve;

Neni 67 - Llogaritë bankare të klubeve

- 67.1 Klubet pjesëmarrëse në Kampionatin Kombëtar të Abissnet Superiore dhe Kupën e Shqipërisë detyrohen të njoftojnë FSHF të dhënat bankare përmes një formulari të posaçëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të paktën dy zyrtarë të klubit.

Neni 68 - E drejta e ekzekutimit të detyrimeve

- 68.1 Detyrimet financiare të parashikuara në këtë rregullore dhe vendimet e organeve juridike të FSHF, të cilat përmbajnë detyrime në të holla janë të detyrueshme për t'u ekzekutuar.
- 68.2 Nëse detyrimet apo vendimet e organeve juridike nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga debitori, dhe ky i fundit ka kredi pranë FSHF-së, ai ekzekutohet nga kjo kredi, prej Sekretariatit Teknik kryesisht ose kërkesë të kreditorit.
- 68.3 Sekretariati Teknik, pasi njofton debitorin, urdhëron Departamentin e Financave të vërë sekuestro mbi kredinë e debitorit dhe ta kalojë atë në favor të kreditorit.
- 68.4 FSHF konsiderohet gjithmonë si kreditor që merr pjesë bashkë me kreditorët e tjerë për detyrimin që po ai debitor i ka FSHF si rrjedhojë e kuotave të papaguara të pjesëmarrjes apo të anëtarësimit.
- 68.5 Detyrimet e vendosura me vendim të organeve të drejtësisë sportive, paguhen me preferim në këtë radhë:
- Kreditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës apo shërbimit për të anëtarësuarit në klube;
 - Kreditë që rrjedhin nga dënimet disiplinore të dhëna kundër klubeve.
 - Detyrimet për anëtarësim apo kuota të papaguara.
- 68.6 Kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, Sekretariati Teknik në bashkëpunim me Sektorin e Financës, përgatit një projekt ndarje, duke veçuar fillimisht shumat për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër, që mbetet, paguan kreditë e tjera.

XIV. SHFRYTËZIMI I TË DREJTAVE TREGTARE

Neni 69 - Hyrje

69.1 Nga pikëpamja e marketingut, është detyra e FSHF të përmbushë qëllimin statutor për zhvillimin e futbollit në Shqipëri duke forcuar pozicionin e këtij sporti në shoqërinë shqiptare. Mundësitë tregtare dhe financiare përdoren në dobi të zhvillimit afat gjatë të futbollit duke respektuar rregullat e tregut.

Neni 70 - Të drejtat tregtare

70.1 FSHF është pronare ekskluzive dhe përfituese e të gjitha të drejtave tregtare. Në përputhje me statutin, FSHF rezervon çdo të drejtë tregtare dhe industriale për të shfrytëzuar dhe shpërndarë të ardhurat prej shfrytëzimit të këtyre të drejtave.

70.2 Shfrytëzimi i të drejtave tregtare të garës:

- a. Të drejtat lidhur me median
 - Të gjitha të drejtat e lidhura me median mbi garat e organizuara nga FSHF shfrytëzohen nga FSHF.
- b. Të drejta të tjera tregtare
 - FSHF gëzon të drejtën ekskluzive për të shfrytëzuar të gjitha të drejtat e tjera tregtare dhe për të bashkëpunuar me partner/sponsor përgjatë garës. Partnerët apo sponsorët mund të kenë të drejtë ekskluzive për të shfrytëzuar të drejta të caktuara.
- c. Të drejtat e klubeve pjesëmarrëse në garë
 - Klubet mund të shfrytëzojnë disa të drejta mediatike në përputhje me këtë rregullore.

- Klubet gëzojnë të drejtën për të shfrytëzuar fragmente (highlights) nga ndeshjet e tyre të cilat vendosen në dispozicion nga FSHF ose të prodhojnë fragmentet në ndeshjet e tyre (me maksimumi një kamera dhe pas aprovimit me shkrim të FSHF) për ta përdorur për qëllimet e tyre si analiza stërvitore etj.
- d. Të drejtat mbi të dhënat statistikore
- FSHF mund të shfrytëzojë të dhënat statistikore të garës, përfshirë të gjitha ndeshjet dhe të autorizojë palë të treta për këtë qëllim.
 - Klubet mund të përpilojnë të dhëna statistikore për ndeshjet e tyre në garë për t'i përdorur për qëllimet e tyre duke pasur të drejtën t'i publikojnë këto të dhëna.
 - Klubet duhet të garantojnë se të dhënat statistikore nuk do të shiten dhe se asnjë palë e tretë nuk mund të asociohet me garën e organizuar nga FSHF.

Neni 71 - Të drejtat tregtare gjatë turit 1/16 të Kupës së Shqipërisë.

- 71.1 Klubet pjesëmarrëse në Kupën e Shqipërisë kanë të drejtë të shfrytëzojnë të drejtat tregtare gjatë pritëse të Turit 1/16 me kusht që marrëveshjet për shfrytëzimin e këtyre të drejtave të mos krijojnë në ndonjë mënyrë një asocim apo lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mes palëve të treta dhe FSHF ose garës.
- 71.2 Të gjitha marrëveshjet për shfrytëzimin e të drejtave duhet të depozitohen në FSHF.
- 71.3 Gjatë turit 1/16, klubet duhet të vendosin në dispozicion të FSHF një kopje të regjistrimit audio-vizual të ndeshjes.

Neni 72 - Të drejtat tretarë gjatë Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë

- 72.1 Përveç sa parashikohen në nenin 69, FSHF gëzon të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të të drejtave tregtare gjatë gjithë tureve të Kupës së Shqipërisë dhe Superkupës së Shqipërisë.

Neni 73 - Të drejtat tregtare të Abissnet Superiore

- 73.1 Partnerët dhe/ose sponsorët e FSHF-së dhe/ose klubeve pjesëmarrëse gëzojnë të drejtën ekskluzive për të shfrytëzuar nga ana tregtare dhe promocionale garën e Abissnet Superiore. Të gjitha emrat, termat, simbolet, logot, maskotat dhe/ose format e tjera artistike, grafike e muzikore lidhur me garën mund të përdoren vetëm nga partnerët dhe/ose sponsorët për qëllimet e tyre tregtare me aprovimin e FSHF-së.
- 73.2 Klubet pjesëmarrëse në garën e Abissnet Superiore, marrin përsipër të garantojnë suportin maksimal për FSHF në mënyrë që të implementohen të drejtat tregtare të parashikuara në këtë rregullore.
- 73.3 Klubet pjesëmarrëse në garën e Abissnet Superiore, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të mbrojtur imazhin e garës duke penguar dhe ndaluar çdo veprim që cënon vlerën tregtare të aktivitetit, FSHF-së, anëtarëve të sajë dhe partnerëve apo sponsorëve.

Neni 74 - Liçensimi dhe tregtimi i produkteve

- 74.1 FSHF gëzon të drejtën e zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të produkteve që lidhen me garat e organizuara prej sajë të tilla si, por pa u kufizuar me maskota, kupa si dhe çdo produkt promocional që mbart pronësinë industriale të FSHF-së në bazë të ligjeve në fuqi.
- 74.2 Klubet pjesëmarrëse autorizojnë FSHF të përdorë materiale fotografike, audio-vizuale të skuadrës, lojtarëve, zyrtarëve (përfshirë emrat, mbiemrat, statistikat dhe fanellat e lojës pa pagesë për gjithë kohëzgjatjen e garës me qëllim kryerjen e aktiviteteve promocionale.

XV. MARRËDHËNIET ME MEDIAT

Neni 75 - Përgjegjësitë lidhur me çështjet e medias

- 75.1 Çdo klub duhet të emërojë një person përgjegjës për median, i cili të koordinojë bashkëpunimin mes Klubit, FSHF-së dhe medias. Përgjegjësi i medias duhet të sigurojë se ambientet e medias të jenë në gjendje pune dhe konform rregullores së infrastrukturës si dhe të koordinojë të gjithë aktivitetet e lidhura me ndeshjen nga pikëpamja mediatike.
- 75.2 Përpara fillimit të çdo sezoni, klubet duhet t'i vendosin në dispozicion FSHF-së të dhënat dhe fotografitë e lojtarëve dhe trajnerit kryesor si dhe fotografi historike të stadimeve apo të dhëna të tjera për qëllime promovionale.

Neni 76 - Intervistat një ditë përpara ndeshjes

- 76.1 Secili nga klubet duhet të kryejë një dalje mediatike në formë konference për shtyp apo intervistë një ditë përpara ndeshjes me pjesëmarrjen e trajnerit të parë dhe të paktën një lojtari. Të dyja daljet mediatike duhet të koordinohen me FSHF në mënyrë që media të jetë prezente tek të dyja.
- 76.2 Në rast se daljet mediatike kryhen në stadiumin e klubit pritës, ky i fundit duhet të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme për të asistuar klubin mik në realizimin e konferencës për shtyp.

Neni 77 - Intervistat në ditën e ndeshjes

- 77.1 Në ditën e ndeshjes mund të kryhen intervista përpara, gjatë dhe pas përfundimit të sajë. Koha dhe vendi duhet të koordinohen paraprakisht me secilin klub dhe FSHF-në.

- a. Klubet duhet të vënë në dispozicion trajnerin e parë për një interviste përpara ndeshjes e cila lidhet vetëm me atë ndeshje. Në pamundësi, një lojtar, zv/trajneri apo një zyrtar i klubit duhet të japë një intervistë përpara ndeshjes.
- b. Intervista të tjera përpara ndeshjes, mund të dakordësohen paraprakisht mes klubit dhe medias.
- c. Një intervistë gjatë pushimit të ndeshjes mund të kryhet me trajnerin kryesor, zv.trajnerin me kusht që të jetë dakordësuar paraprakisht.
- d. Në përfundim të ndeshjes, trajneri kryesor dhe/ose një lojtar i rëndësishëm i ndeshjes duhet të japin një intervistë për median.
- e. Intervistat pas ndeshjes janë të detyrueshme për t'u realizuar. Çdo klub duhet të japë të paktën tre intervista tek transmetuesi kryesor dhe të paktën një tek transmetuesit e tjerë. Klubet duhet të sigurojnë që trajneri dhe/ose lojtarët e kërkuar për intervistë të jenë të disponueshëm brenda 15 minutave nga përfundimi i ndeshjes.
- f. Në rast se trajneri i parë largohet me masë disiplinore, klubi duhet ta zëvendësojë detyrimisht me zv.trajnerin.

Neni 78 - Aksesi i mediave

- 78.1 Dhomat e zhveshjes nuk mund të aksesohen nga media, me përjashtim kur klubi dhe FSHF dakordësojnë ndryshe.
- 78.2 Asnjë përfaqësues i medias nuk lejohet të hyjë në fushën e lojës përpara, gjatë dhe pas ndeshjes me përjashtim të ekipit të kameramanëve gjatë rreshtimit të ekipeve.
- 78.3 Të gjithë përfaqësuesit e medias, përfshirë fotografët, gazetarët, kameramanët etj duhet detyrimisht të jenë të pajisur me akreditimin përkatës për të hyrë në stadium.

Neni 79 - Hapësirat e punës për mediat

79.1 Klubet duhet të vendosin në dispozicion një hapësirë të posaçme pune për përfaqësuesit e akredituar të medias në përputhje me rregulloren e infrastrukturës së FSHF-së.

Neni 80 - Hapësirat e punës për transmetuesit audio vizual

80.1 Klubet duhet të krijojnë infrastrukturën e nevojshme për transmetuesit audio vizual të garës duke përfshirë asistencën teknike, energjinë elektrike, pozicionet e vendosjes së kamerave etj.

XVI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 81 - Zbatimi i rregullores

81.1 Administrata e FSHF është përgjegjëse për mirë administrimin e garës dhe ka të drejtë të marrë vendimet e nevojshme për zbatimin e rregullores.

Neni 82 - Raste të pa parashikuara

82.1 Çështje të cilat nuk janë parashikuar në këtë rregullore, të tilla si forca madhore, do të vendosen rast pas rasti nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të pengesave kohore, çështjet do të vendosen nga Presidenti i FSHF-së ose në mungese të tij nga Sekretari i Përgjithshëm. Këto vendime janë të formës së prerë.

Neni 83 - Mos respektimi i rregullores

83.1 Mos respektimi i rregullores sjell si pasojë marrjen e masave disiplinore në përputhje me Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së.

Neni 84 - Anekset

84.1 Të gjithë anekset që i bashkëlidhen kësaj rregullore janë pjesë integrale e sajë.

Neni 85 - Miratimi dhe hyrja në fuqi

85.1 Kjo rregullore u miratua nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së në mbledhjen e datës 28 Gusht 2023 dhe hyn në fuqi menjëherë.

Presidenti

Sekretari i Përgjithshëm

Armand Duka

Ilir Shulku

ANEKSI 1

FORMULARI I REGJISTRIMIT NË GARË

Marrëveshja e Pjesëmarrjes në Garë

Akt - Marrëveshje

Kjo Akt-Marrëveshje (këtu e më poshtë marrëveshja) lidhet midis Palëve si më poshtë:

Federatës Shqiptare të Futbollit, me adresë në Tiranë, Rr. Liman Kaba, Nd 5, H 1, Njësia Administrative 5, Kodi Postar 1019, Tiranë e regjistruar si Person Juridik pranë Gjykatës së shkallës së parë Tiranë, me Vendim Nr. _____, dt. ___/___/_____, ligjërisht e përfaqësuar nga Presidenti, z. Armando Duka, e cila këtu e në vijim do të quhet FSHF.

Dhe

Klubit të Futbollit _____, i përfaqësuar nga z. _____, lindur më ___/___/_____, në _____, Shqipëri, me rezidencë në _____, me shtetësi _____, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar me dokument identifikimi letërnjoftim ID, me nr. _____, këtu e në vijim i quajtur KLUBI.

Palët bien dakord si më poshtë:

I) Qëllimi dhe Kushtet e Përgjithshme të Marrëveshjes

- i) Kjo marrëveshje rregullon ligjërisht marrëdhëniet midis palëve në këtë marrëveshje, gjatë zhvillimit të Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për sezonin 2023/2024, për Abissnet Superiore.

- ii) Pjesë përbërëse dhe e pandarë të kësaj marrëveshje janë:
 - a. Statuti dhe rregulloret e Federatës Shqiptare të Futbollit.
 - b. Kodi i Disiplinës Sportive të FSHF-së.
 - c. Rregullorja e Veprimtarisë Futbollistike, Sezoni 2023/2024, Kampionati Kombëtar i Futbollit, për Abissnet Superiore.
 - d. Statutet dhe Rregulloret e UEFA dhe FIFA.
 - e. Ligjet e Lojës të lëshuara nga IFAB.
- iii) Klubi pranon zbatimin me përpikmëri të statuteve dhe rregulloreve të përmendura më sipër për gjithçka që është në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe legjislacionin sportiv në veçanti.
- iv) Klubi pranon autoritetin disiplinor të FSHF-së dhe i nënshtrohet vendimeve të organeve juridike të FSHF-së, si dhe të autoriteteve të futbollit të përmendura më sipër (UEFA dhe FIFA) për gjithçka që është nën juridiksionin e tyre.
 - a. Në zbatim të këtij paragrafi, klubi pranon vendosjen e sanksioneve financiare ndaj tij deri në vlerat e përcaktuara në rregulloret e FSHF-së, dhe në Kodin e Disiplinës Sportive të FSHF-së.
- v) Klubi merr përsipër dhe mban përgjegjësi për veprimet e kryera ose të mbetura në tentativë, nga zyrtarët, lojtarët, agjentët, përfaqësuesit dhe tifozët e vet përkatës, të cilat bien ndesh ose shkelin përcaktimet dokumenteve rregulluese të përcaktuara në paragrafin (ii) këtu më sipër në këtë nen.

II) Kohëzgjatja e Marrëveshjes

- i. Kjo marrëveshje hyn në fuqi më datë ___/___/_____, dhe lidhet për një periudhë deri në fillimin e sezonit futbollistik pasardhës.

III) Detyrimet dhe Përgjegjësitë e Klubit

- i. Klubi mban përgjegjësi për zbatimin e përcaktimeve në Rregulloren e Veprimtarisë Futbollistike, Kampionati Kombëtar i Futbollit, për sezonin 2023/2024
- ii. Klubi detyrohet të paguajë brenda afateve të përcaktuara në rregulloret përkatëse, ose afatet e vendosura rast pas rasti nga FSHF, të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga përcaktimet e rregulloreve të FSHF-së, ose që rrjedhin nga vendimet disiplinore të organeve juridike për sanksionimin financiar të klubit.
- iii. Klubi detyrohet të ruajë emrin e mirë të FSHF-së dhe të mos kryejë asnjë veprim që mund të dëmtojë FSHF-në, veçanërisht para dhe gjatë veprimtarive në të cilat Klubi merr pjesë.
- iv. Klubi detyrohet të marrë pjesë në të gjitha ndeshjet e përcaktuara në kalendarin e shpallur në Rregulloren e Veprimtarisë Futbollistike, për sezonin 2023/2024, Kampionati Kombëtar i Futbollit, për Abissnet Superiore.

IV) Detyrimet dhe Përgjegjësitë e FSHF-së

- i. FSHF mbulon me siguracion të gjitha risqet në lidhje me përgjegjësitë që ka FSHF për organizimin dhe zhvillimin e ndeshjeve zyrtare, siç përcaktohet në këtë rregullore. FSHF ka përgjegjësi për të mbuluar me siguracion:
 - a) aksidentet e shkaktuara ndaj delegatit/ve të ndeshjes jashtë kohëzgjatjes së ndeshjes zyrtare përkatëse.
- ii. Nëpërmjet organeve të kontrollit të brendshëm, FSHF do të garantojë zbatimin me përpikmëri të përcaktimeve të Rregullores së Veprimtarisë Futbollistike, për sezonin 2023/2024, të Kampionatit Kombëtar të Futbollit për Abissnet Superiore, nga të gjithë punonjësit, zyrtarët (përfshirë këtu dizajnerin e arbitrave, arbitrat, krye-vëzhguesin e arbitrave, vëzhguesit e arbitrave, delegatët e ndeshjes, dhe çdo person

tjetër që përfaqëson FSHF-në, në ndeshjet zyrtare), agjentët, inspektorët ose përfaqësuesit e FSHF-së që ushtrojnë funksione në zbatim të kësaj rregulloreje, duke vënë para përgjegjësisë çdo shkelës ose kundërvajtës. Në zbatim të këtij paragrafi, punonjësit, zyrtarët, agjentët, inspektorët ose përfaqësuesit e FSHF-së që shkelin ndonjë përcaktim të kësaj rregulloreje, me vetëdije ose nga pakujdesia:

- a. do të shkarkohen nga pozicioni i punës përkatëse;
 - b. do të ngarkohen me përgjegjësi materiale për pasojat që shkaktojnë shkeljet ose kundërvajtjet e tyre ndaj klubeve ose të tretëve.
- iii. FSHF do të garantojë kualifikimin profesional të të gjithë punonjësve, zyrtarëve (përfshirë këtu dizajnerin e arbitrave, arbitrat, kryevëzhguesin e arbitrave, vëzhguesit e arbitrave, delegatët e ndeshjes, dhe çdo person tjetër që përfaqëson FSHF-në, në ndeshjet zyrtare), agjentëve, inspektorëve ose përfaqësuesve të FSHF-së që ushtrojnë funksione në zbatim të kësaj rregulloreje, duke kryer trajnime dhe provime (testime) ndaj personave të përmendur në këtë paragraf, në mënyrë të vazhdueshme, në lidhje me zbatimin e kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të tjera të zbatueshme në lidhje me zhvillimin e Kampionatit Kombëtar të Futbollit, për Abissnet Superiore. Në zbatim të këtij paragrafi, FSHF ka përgjegjësi të skualifikojë çdo person që nuk i nënshtrohet provimeve (testimeve) në mënyrë të suksesshme.

V) Dispozita Përfundimtare

- i. Çdo shtesë, ndryshim ose anulim i ndonjë pjese të Marrëveshjes duhet të bëhet me shkrim nga të dyja Palët. Marrëveshjet me gojë nuk janë të vlefshme.
- ii. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, nga një për secilën Palë.

- iii. Pavlefshmëria e ndonjë klauzole të veçantë nuk ndikon në vlefshmërinë e pjesës tjetër të marrëveshjes.

Vendi dhe Data

Vendi dhe Data

Nënshkrimi i FSHF

Nënshkrimi i Klubit

ANEKSI 2

KALENDARI I NDESHJEVE SEZONI 2023-24

FAZA 1		FAZA 2	
Java 1		Java 10	
Partizani	Teuta	Teuta	Partizani
Laçi	Erzeni	Erzeni	Laçi
Vllaznia	Kukësi	Kukësi	Vllaznia
Egnatia	Skënderbeu	Skënderbeu	Egnatia
Dinamo	Tirana	Tirana	Dinamo
Java 2		Java 11	
Partizani	Laçi	Laçi	Partizani
Skënderbeu	Dinamo	Dinamo	Skënderbeu
Kukësi	Egnatia	Egnatia	Kukësi
Erzeni	Vllaznia	Vllaznia	Erzeni
Teuta	Tirana	Tirana	Teuta
Java 3		Java 12	
Laçi	Teuta	Teuta	Laçi
Vllaznia	Partizani	Partizani	Vllaznia
Egnatia	Erzeni	Erzeni	Egnatia
Dinamo	Kukësi	Kukësi	Dinamo
Tirana	Skënderbeu	Skënderbeu	Tirana
Java 4		Java 13	
Partizani	Egnatia	Egnatia	Partizani
Laçi	Vllaznia	Vllaznia	Laçi
Kukësi	Tirana	Tirana	Kukësi
Erzeni	Dinamo	Dinamo	Erzeni
Teuta	Skënderbeu	Skënderbeu	Teuta

Java 5

Vllaznia	Teuta
Egnatia	Laçi
Dinamo	Partizani
Tirana	Erzeni
Skënderbeu	Kukësi

Java 6

Partizani	Tirana
Laçi	Dinamo
Vllaznia	Egnatia
Erzeni	Skënderbeu
Teuta	Kukësi

Java 7

Egnatia	Teuta
Dinamo	Vllaznia
Tirana	Laçi
Skënderbeu	Partizani
Kukësi	Erzeni

Java 8

Partizani	Kukësi
Laçi	Skënderbeu
Vllaznia	Tirana
Egnatia	Dinamo
Teuta	Erzeni

Java 9

Dinamo	Teuta
Tirana	Egnatia
Skënderbeu	Vllaznia
Kukësi	Laçi
Erzeni	Partizani

Java 14

Teuta	Vllaznia
Laçi	Egnatia
Partizani	Dinamo
Erzeni	Tirana
Kukësi	Skënderbeu

Java 15

Tirana	Partizani
Dinamo	Laçi
Egnatia	Vllaznia
Skënderbeu	Erzeni
Kukësi	Teuta

Java 16

Teuta	Egnatia
Vllaznia	Dinamo
Laçi	Tirana
Partizani	Skënderbeu
Erzeni	Kukësi

Java 17

Kukësi	Partizani
Skënderbeu	Laçi
Tirana	Vllaznia
Dinamo	Egnatia
Erzeni	Teuta

Java 18

Teuta	Dinamo
Egnatia	Tirana
Vllaznia	Skënderbeu
Laçi	Kukësi
Partizani	Erzeni

	FAZA 3
Java 19	
Partizani	Teuta
Laçi	Erzeni
Vllaznia	Kukësi
Egnatia	Skënderbeu
Dinamo	Tirana

Java 20	
Partizani	Laçi
Skënderbeu	Dinamo
Kukësi	Egnatia
Erzeni	Vllaznia
Teuta	Tirana

Java 21	
Laçi	Teuta
Vllaznia	Partizani
Egnatia	Erzeni
Dinamo	Kukësi
Tirana	Skënderbeu

Java 22	
Partizani	Egnatia
Laçi	Vllaznia
Kukësi	Tirana
Erzeni	Dinamo
Teuta	Skënderbeu

Java 23	
Vllaznia	Teuta
Egnatia	Laçi
Dinamo	Partizani
Tirana	Erzeni
Skënderbeu	Kukësi

	FAZA 4
Java 28	
Teuta	Partizani
Erzeni	Laçi
Kukësi	Vllaznia
Skënderbeu	Egnatia
Tirana	Dinamo

Java 29	
Laçi	Partizani
Dinamo	Skënderbeu
Egnatia	Kukësi
Vllaznia	Erzeni
Tirana	Teuta

Java 30	
Teuta	Laçi
Partizani	Vllaznia
Erzeni	Egnatia
Kukësi	Dinamo
Skënderbeu	Tirana

Java 31	
Egnatia	Partizani
Vllaznia	Laçi
Tirana	Kukësi
Dinamo	Erzeni
Skënderbeu	Teuta

Java 32	
Teuta	Vllaznia
Laçi	Egnatia
Partizani	Dinamo
Erzeni	Tirana
Kukësi	Skënderbeu

Java 24

Partizani	Tirana
Laçi	Dinamo
Vllaznia	Egnatia
Erzeni	Skënderbeu
Teuta	Kukësi

Java 25

Egnatia	Teuta
Dinamo	Vllaznia
Tirana	Laçi
Skënderbeu	Partizani
Kukësi	Erzeni

Java 26

Partizani	Kukësi
Laçi	Skënderbeu
Vllaznia	Tirana
Egnatia	Dinamo
Teuta	Erzeni

Java 27

Dinamo	Teuta
Tirana	Egnatia
Skënderbeu	Vllaznia
Kukësi	Laçi
Erzeni	Partizani

Java 33

Tirana	Partizani
Dinamo	Laçi
Egnatia	Vllaznia
Skënderbeu	Erzeni
Kukësi	Teuta

Java 34

Teuta	Egnatia
Vllaznia	Dinamo
Laçi	Tirana
Partizani	Skënderbeu
Erzeni	Kukësi

Java 35

Kukësi	Partizani
Skënderbeu	Laçi
Tirana	Vllaznia
Dinamo	Egnatia
Erzeni	Teuta

Java 36

Teuta	Dinamo
Egnatia	Tirana
Vllaznia	Skënderbeu
Laçi	Kukësi
Partizani	Erzeni

ANEKSI 3

LISTA E LOJTARËVE TË TRAJNUAR NË KLUB

Lojtar të trajnuar në klub; lojtari duhet të ketë qenë pjesë e klubit nga mosha 15 (pesëmbëdhjetë) vjeç deri në moshën 21 (njëzet e një) vjeç për 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj në vazhdimësi.

Lojtar të trajnuar në Federatë; lojtari duhet të ketë qenë pjesë e FSHF-së nga mosha 15 (pesëmbëdhjetë) vjeç deri në moshën 21 (njëzet e një) vjeç për 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj në vazhdimësi në FSHF

Lista aktuale	Lojtar të lirë	Lojtar të trajnuar në klub	Lojtar të trajnuar në FSHF
25	17	8	0
25	17	7	1
25	17	6	2
25	17	5	3
25	17	4	4
24	17	7	0
24	17	6	1
24	17	5	2
24	17	4	3
24	17	3	4
23	17	6	0
23	17	5	1
23	17	4	2
23	17	3	3
23	17	2	4
22	17	5	0
22	17	4	1
22	17	3	2

RREGULLORE E VEPRIMTARISË FUTBOLLISTIKE

Lista aktuale	Lojtar të lirë	Lojtar të trajnuar në klub	Lojtar të trajnuar në FSHF
22	17	2	3
22	17	1	4
21	17	4	0
21	17	3	1
21	17	2	2
21	17	1	3
21	17	0	4
20	17	3	0
20	17	2	1
20	17	1	2
20	17	0	3
19	17	2	0
19	17	0	2
19	17	1	1
18	17	1	0
18	17	0	1
17	17	0	0

ANEKSI 4

KONTRATA STANDARDE E LOJTARIT

KONTRATË SHËRBIMI LOJTARI

e lidhur midis klubit të futbollit _____
dhe lojtarit _____

Kjo Kontratë Shërbimi (këtu e më poshtë Kontrata) lidhet midis Palëve si më poshtë:

SHOQËRISË “ _____ ”, me adresë në _____,
e regjistruar si Person Juridik pranë Gjykatës së shkallës së parë
Tiranë, me Vendim Nr. _____, dt. _____, ligjërisht e
përfaqësuar nga Administratori, _____, e cila
këtu e në vijim do të quhet KLUBI.

Dhe

Lojtarit _____

_____, i cili këtu e
në vijim do të quhet LOJTARI.

Palët bien dakord si më poshtë:

I. Qëllimi dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit

- i. Kjo kontratë rregullon ligjërisht marrëdhëniet midis palëve në këtë kontratë punësimi.
- ii. Pjesë përbërëse dhe e pandarë të kësaj kontrate janë:
 - a. Statutet dhe rregulloret e Federatës Shqiptare të

- Futbollit.
- b. Statutet dhe Rregulloret e UEFA-s dhe FIFA-s (ku përfshihen dhe Ligjet e Lojës të lëshuara nga IFAB).
 - c. Marrëveshjet kolektive të cilat mund të lidhen në të ardhmen.
 - d. Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes, Kodi i Veshjes, Kodi i Vlerave, Misioni dhe Vizioni, dhe rregulloret e Klubit.
- iii. Lojtari pranon zbatimin me përpikmëri të statuteve dhe rregulloreve të përmendura më sipër për gjithçka që është në përputhje me legjislacionin shqiptar më përgjithësi dhe legjislacionin sportiv në veçanti. Lojtari pranon se rregulloret e miratuara prej Klubit ju vunë në dispozicion dhe pasi i lexoi ju shpjeguan përpara nënshkrimit të kontratës. Rregulloret e FSHF-së, UEFA-s FIFA-s, dhe rregulloret e Klubit, i janë vënë në dispozicion në selinë e Klubit.
 - iv. Lojtari pranon autoritetin disiplinor të Klubit dhe i nënshtrohet vendimeve të organeve të administrimit të Klubit që janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe rregulloret e futbollit, si dhe të autoriteteve të futbollit të përmendura më sipër (Federata Shqiptare e Futbollit, UEFA dhe FIFA) për gjithçka që është nën juridiksionin e tyre.

II. Kohëzgjatja e Kontratës

- i. Kjo Kontratë lidhet për një periudhë kohe duke filluar nga data ___/___/_____, deri më datën ___/___/_____.
- ii. Vlefshmëria e kësaj Kontrate varet drejtpërdrejtë nga kushtet si më poshtë:
 - a. Konfirmimin nga FSHF-ja, nese Lojtari gëzon të drejtën të aktivizohet në veprimtaritë zyrtare të Klubit;
 - b. Rezultatet e kontrollit mjekësor.
- iii. Orët e punës së lojtarit varrojnë sipas kërkesës së arsyeshme të Klubit për të përmbushur detyrat e tij dhe Lojtarit nuk i

njihet e drejta të kërkojë shpërblim shtesë për punë të kryer jashtë orarit normal të punës.

- iv. Vendi i punës do të jetë në ambjentet stërvitore dhe në ambjentet e tjera të Klubit, dhe pavarësisht kësaj, Klubi ka të drejtë t'i kërkojë Lojtarit të luajë dhe të kryejë detyrat e tij në çdo vend tjetër të përcaktuar nga Klubi.

III. Detyrimet e Përgjithshme të Lojtarit

- i. Lojtari do të mbajë përgjegjësi kontraktuale për përmbushjen e objektivave të ndryshëm të Klubit të vendosura dhe të shpallura para çdo veprimtarie futbolistike.
- ii. Lojtari detyrohet të ruajë emrin e mirë të Klubit dhe të mos kryejë asnjë veprim që mund të dëmtojë Klubin, veçanërisht para dhe gjatë veprimtarive në të cilat Klubi merr pjesë.
- iii. Lojtari është i detyruar të marrë pjesë në:
 - a. Të gjitha ndeshjet, veprimtaritë dhe stërvitjet e Klubit (në veprimtaritë e parashikuara për të gjithë lojtarët, ashtu edhe për veprimtaritë ose stërvitjet e parashikuara individualisht për Lojtarin në veçanti).
 - b. Të gjitha mbledhjet e lojtarëve dhe në çdo organizim tjetër me qëllim përgatitjen për ndeshje dhe veprimtari. Kjo do të zbatohet edhe në rastet kur pjesëmarrja e tij si lojtar ose lojtar rezervë nuk ishte parashikuar.
- iv. Në mënyrë të arsyeshme t'i nënshtrohet trajtimit atletik dhe terapeutik të udhëzuar prej personit të autorizuar nga Klubi.
- v. Të luajë duke shfrytëzuar aftësitë e tij më të mira gjatë gjithë kohës.
- vi. Te japë të gjitha autorizimet e nevojshme për lëshimin në favor të Klubit të të gjitha të dhënave të tij mjekësore dhe të tregojë të njëjtën gatishmëri gjatë gjithë kohëzgjatjes së

- kësaj kontrate.
- vii. Të luajë futboll vetëm për Klubin, ose siç autorizohet nga Klubi, ose siç parashikohet nga Rregulloret e FIFA-s, UEFA-s dhe FSHF-së.
 - viii. Ti nënshtrohet menjëherë ekzaminimeve mjekësore nëse kjo i kërkohet nga Klubi dhe ti nënshtrohet trajtimeve të tilla të përcaktuara nga këshilltarët mjekësorë të Klubit.
 - ix. Të marrë pjesë në të gjitha udhëtimet brenda dhe jashtë vendit, duke përdorur mënyrën e transportit të organizuar nga Klubi.
 - x. Të tregojë kujdes gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, për të gjitha mjetet dhe pajisjet e dhëna në përdorim nga Klubi si dhe t'ia kthejë ato Klubit sipas rastit ose pas përfundimit të Kontratës.
 - xi. Të sillet në mënyrë të tillë që të mos dëmtojë imazhin e Klubit, të FSHF-së dhe sportit të futbollit në përgjithësi.
 - xii. Të mos bëjë asnjë koment me palë të treta mbi çështje që i përkasin Klubit. Lojtari është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacioneve që ai ka marrë dijeni gjatë veprimtarisë së tij pranë Klubit. Përcaktimi i informacionit konfidencial parashikohet në rregulloret dhe aktet e tjera të Klubit.
 - xiii. Të kërkojë miratimin me shkrim të presidentit në rast se dëshiron të transferohet pranë ndonjë ekipi (klubi) tjetër, si dhe të paguajë të gjitha detyrimet financiare, të cilat do t'i kërkohen nga klubi si tarifën e kompensimit dhe detyrimet e tjera nëse përcaktohen në kontratë.

IV. Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Gjendjes Fizike të Lojtarit

- i. Lojtari merr përsipër të shfrytëzojë të gjithë talentin dhe gjendjen e tij fizike në të mirë të Klubit, të bëjë të gjitha përpjekjet për të mirëmbajtur dhe për të përmirësuar nivelin e gjendjes së tij fizike, mendore, dhe psikike. Në përgjithësi

- Lojtari duhet të tregojë kujdes për për të mos ndërmarrë asnjë veprim që mund të ulë efektivitetin e tij profesional.
- ii. Lojtari duhet të mirëmbajë treguesit dhe parametrat e gjendjes fizike individuale në normat optimale të vlerësuara e të përcaktuara nga Klubi. Lojtari njoftohet rast pas rasti për kërkesat e Klubit në lidhje me normat e parametrave dhe treguesve të gjendjes fizike që ai duhet të përmbushë.
 - iii. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Lojtari heq dorë nga:
 - a. ushtrimi i ndonjë sporti ose aktiviteti, edhe gjatë periudhës së pushimeve, që mund të përbëjë rrezik për dëmtime fizike. Në veçanti ndalohet ushtrimi i sporteve të patinazhit, skive, snowboard, hedhjes me parashutë, kalërimit, motociklizmit;
 - b. ushtrimi i ndonjë sporti tjetër pa miratimin paraprak me shkrim prej Klubit.

V. Përdorimi i Të Drejtave Personale të Lojtarit

- i. Lojtari e autorizon Klubin të përdorë të drejtat e tij personale dhe ti shfrytëzojë në mënyrë individuale apo kolektive. Të drejtat përfshijnë por nuk kufizohen në:
 - a. përdorimin e veshjeve dhe materialeve të tjera sportive sipas udhëzimeve të Klubit;
 - b. shpërndarjen e fotografive të Lojtarit nëpërmjet medias ekzistuese ose të ardhme;
 - c. të drejtat mbi firmat, autografet dhe firmat e zakonshme sipas përcaktimeve të Klubit;
 - d. reklamat e ndryshme si dhe çdo lloj marketingu personal apo në kuadrin e grupit (për reklamimin e produkteve, personave e shërbimeve të ndryshme);
 - e. aktivitete dhe të tjera nëpërmjet të cilave Klubi mund të shfrytëzojë emrin dhe imazhin e lojtarit.

VI. Kujdesi Shëndetësor

- i. Klubi është i detyruar të kryejë me shpenzimet e veta sigurimin shëndetësor të lojtarit.
- ii. Përpara fillimit të çdo sezoni futbollistik Lojtari është i detyruar të kryejë analizat shëndetësore për të verifikuar aftësinë e tij për të ushtruar sportin e futbollit dhe për të përmbushur veprimtarinë sportive pranë Klubit.
- iii. Lojtari merr përsipër të zbatojë të gjitha udhëzimet mjekësore të diktuar nga mjekët e autorizuar nga Klubi, me qëllim mirëmbajtjen dhe përmirësimin e formës sportive në përputhje me përcaktimet në nenin IV (Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Gjendjes Fizike të Lojtarit), të kësaj marrëveshje.

VII. Detyrimet e Lojtarit në Raste të Sëmundjeve dhe Aksidenteve.

- i. Nëse Lojtari e ka të pamundur të marrë pjesë në veprimtaritë e Klubit, për shkak të pësimit të ndonjë sëmundje apo aksidenti, Lojtari është i detyruar të njoftojë menjëherë Trajnerin e ekipit të parë të Klubit, dhe personelin administrativ të Klubit.
- ii. Lojtari është i detyruar të paraqesë pranë administratës së Klubit të gjithë dokumentacionin mjekësor në lidhje me vlerësimin shëndetësor të kryer në rastin e pësimit të sëmundjes apo aksidentit përkatës, jo më vonë se dy (2) ditë nga pësimi i sëmundjes apo aksidentit.
- iii. Në rast se lojtari do të bëhet i paaftë për të luajtur për arsye të një dëmtimi apo sëmundjeje (përfshirë sëmundjet ose çrregullimet mendore) Klubi duhet të paguajë lojtarin gjatë periudhës së paaftësisë ose kohëzgjatjes së kontratës (atë që është më e shkurtër) shumë e mëposhtme të shpërblymit për periudhat si më poshtë:
 - a. në rast dëmtimi të lojtarit gjatë ndeshjeve, lojtari do të marrë pagën bazë deri në fund të 7 (shtatë) muajve të parë të kohëzgjatjes së kontratës;

- b. në rast të çdo dëmtimi apo sëmundjeje tjetër, lojtari do të marrë pagën bazë deri në fund të 6 (gjashtë) muajve të parë të kohëzgjatjes së kontratës.

VIII. Sekret i Mjekësor

- i. Lojtari çliron nga përgjegjësia e konfidencialitetit shëndetësor, të gjithë mjekët dhe Klubin, në lidhje me informacionet e tij shëndetësore vetjake që janë thelbësore për ushtrimin e veprimtarisë sportive pranë Klubit.

IX. Detyrimet e Klubit

- i. Shpërblimi i Lojtarit - Për shërbimet e kryera ndaj Klubit, Lojtari do të përfitojë pagën siç përcaktohen në Shtojcën 1 - Shpërblimi i Lojtarit, bashkëngjitur kësaj Kontrate.
- ii. Klubi mund të zbresë nga shpërblimi i pagueshëm i Lojtarit:
 - a. gjobat e vendosura ndaj Lojtarit, sipas parashikimeve të kësaj Kontrate;
 - b. të gjitha shumat që Klubi ka paguar në favor të Lojtarit me pëlqimin paraprak të këtij të fundit;
 - c. çdo shumë tjetër të cilat duhet të jenë të përcaktuara qartë se Lojtari ja detyron Klubit;
 - d. Shumat për zhdëmtimin e dëmeve të shkaktuara nga Lojtari në dëm të pasurisë së Klubit, përfshirë këtu edhe dëmtimin e imazhit dhe/ose emrit të mirë të Klubit.
- iii. Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, Klubi do të vërë në shërbim të Lojtarit:
 - a. personel të kualifikuar për ndeshje dhe stërvitje;
 - b. vende të përshtatshme për lojë dhe stërvitje, si dhe infrastrukturën tjetër të nevojshme në përputhje me udhëzimet e FSHF-së;
 - c. kujdes mjekësor dhe terapeutik me karakter sportiv;
 - d. veshje sportive (përveç sigurimit të këpucëve të lojës);

- e. programin stërvitor (përfshirë ndryshimet e mundshme);
- iv. Klubi pranon se nuk mund të bëjë politikë diskriminimi ndaj Lojtarit.
- v. Klubi, në përputhje me rregullat e FIFA-s, pranon të lejojë Lojtarin kur ai thirret në Ekipin Kombëtar.

X. Masat Disiplinore dhe Sanksionet

- i. Në qoftë se Lojtari shkel ndonjë nga detyrimet e tij të përcaktuara në këtë Kontratë, ose nuk përmbush objektivat e vendosura rast pas rasti nga Klubi, Klubi mund të aplikojë penaltitetet e mëposhtme, krahas të gjitha gjobave dhe sanksioneve të parashikuara në rregulloret e Klubit.
 - a. Qortim.
 - b. Gjobë
 - c. Përrjashtim të përkohshëm nga ndeshjet zyrtare.
 - d. Përrjashtim të përkohshëm nga stërvitjet apo veprimtaritë e tjera të organizuara apo zhvilluara nga Klubi.
 - e. Përrjashtim nga Klubi.
- ii. Për efekt vlefshmërie, masat disiplinore dhe sanksionet duhet t'i njoftohen detyrimisht edhe Federatës Shqiptare të Futbollit brenda 5 (pesë) ditësh.

XI. Dopingu dhe Substancat e Ndaluar

- i. Dopingu është përdorimi i substancave të përfshira në listën e substancave të ndaluara dhe përdorimi i metodave të ndaluara në listën e FSHF-së, UEFA-s, dhe FIFA-s.
- ii. Dopingu ose përdorimi i substancave të ndaluara është rreptësisht i ndaluar. Lojtari që merr substanca të ndaluara ose inkurajon dopingun në çdo lloj mënyre, i nënshtrohet vendimit të Komisionit të Kontrollit dhe Disiplinës të FSHF-së ose organizatave ndërkombëtare, si të jetë rasti.

- iii. Konsumimi i alkoolit dhe duhanit është rreptësisht i ndaluar, dhe për këtë arsye Lojtari do të jetë në kontrollin e vazhdueshëm të Klubit.
- iv. Lojtari është i detyruar të lejojë Klubin dhe personelin e Klubit të kryejë ekzaminime sa herë që kërkohet prej Klubit.

XII. Transferimi i Lojtarit

- i. Klubi ka të drejtë të transferojë të drejtën e federimit të Lojtarit, tek një klub tjetër, brenda ose jashtë vendit, në përputhje me interesat e veta, duke respektuar të drejtat e Lojtarit, të parashikuara në rregulloret e FSHF-së, UEFA-s, dhe FIFA-s.

XIII. Përfundimi i Kontratës nga ana e Klubit

- i. Klubi do të konsiderohet se e zgjidh kontratën me Lojtarin me shkak të ligjshëm duke njoftuar lojtarin me shkrim 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara në rast se lojtari:
 - a. gjendet fajtor për një shkelje të rëndë të ligjit;
 - b. nuk do të marrë parsysh çdo paralajmërim me shkrim të dhënë nga ana e klubit;
 - c. është dënua për një vepër penale për të cilën, dënimi konsiston në burgimin për të paktën një muaj ose më shumë.
 - d. gjendet e fajtor për shkelje të Nenit XI
- ii. Në rast se Klubi përfundon kontratën me lojtarin sipas paragrafit (i), këtu më sipër, është i detyruar t'i njoftojë Lojtarit me shkrim për të gjitha arsyet e vendimit të marrë për zgjidhjen e kontratës.
- iii. Paguesa e lojtarit gjatë periudhës së njoftimit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh do të kryhet menjëherë.

XIV. Përfundimi i Kontratës nga ana e Lojtarit

- i. Lojtari do të konsiderohet se e zgjidh kontratën me Klubin me shkak të ligjshëm duke njoftuar Klubin me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara, në rast se Klubi:
 - a. do të gjendet fajtor për shkelje serioze dhe të vazhdueshme të kushteve dhe rrethanave të kësaj kontrate; ose
 - b. dështon në pagimin e ndonjë shpërblimi, ose pagesa të tjera, ose bonuse që i detyrohen Lojtarit, sipas kësaj kontrate, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga afati kur duheshin përmbushur detyrimet përkatëse.
- ii. Nëse klubi përmbush detyrimet e veta brenda periudhës së njoftimit prej 30 (tridhjetë) ditësh sipas paragrafit (i), këtu më sipër në këtë nen, atëherë Lojtari nuk mund të zgjidhë këtë kontratë në mënyrë të njëanshme për shkak të ligjshëm.

XV. Përfundimi i Kontratës

- i. Kjo Kontratë përfundon në afatin e përcaktuar këtu më sipër (II/i - Kohëzgjatja e Kontratës).
- ii. Kjo Kontratë mund të përfundojë përpara afatit të përcaktuar këtu më sipër, me marrëveshje të shkruar midis Palëve.
- iii. Me përfundimin e Kontratës, Lojtari është i detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj Klubit. Së bashku me detyrimet financiare do të paguhen dhe interesat përkatëse.
- iv. Me përfundimin e Kontratës, në çdo rast, Lojtari detyrohet t'i kthejë Klubit çdo pronë (përfshirë edhe mjetet personale të dhëna në përdorim), si dhe të gjithë bazën materiale të dhënë në përdorim nga Klubi.

XVI. Rishikimi i kontratës

- i. Palët, bien dakord, se periudha 60 (gjashtëdhjetë) ditore përpara datës së përfundimit të kësaj kontratë, do të

shërbejë si periudhë negociatash për rinovimin e kontratës apo rishikimin e kushteve të saj.

- ii. Nëse, brenda periudhës 60 (gjashtëdhjetë) ditore të përmendur më sipër, palët nuk arrijnë një marrëveshje me shkrim për rinovimin, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur në datën e përcaktuar në Nenin II.

XVII. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

- i. Palët bien dakord se mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës, do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve pranë FSHF.

XVIII. Njoftimet dhe Reklamimet

- i. Njoftimet që lidhen me detyrimet e palëve për zbatimin e kësaj kontrate, bëhen sipas rastit me gojë dhe me shkrim.
- ii. Palët marrin përsipër të njoftojnë njëra - tjetrën menjëherë për ndryshime të papritura lidhur me detyrimet respektive.
- iii. Njoftimet për zgjidhjen e kontratës, kërkimin e një të drejtë, apo përmbushjes së një detyrimi që rrjedh nga kontrata ose ligji, për efekt të njohjes dhe ushtrimit të saj, duhet të bëhen vetëm me shkrim. Për efekt vlefshmërie, një kopje e njoftimit, duhet detyrimisht të depozitohet pranë Federatës Shqiptare të Futbollit.
- iv. iv. Njoftimet për Klubin do të kryhen në adresën:
Rr "_____" Nr. XX, Tiranë; email: ____@____.com; Fax:

- v. Njoftimet për Lojtarin do të kryhen në adresën:
"_____",Tiranë; email: ____@____.com;
- vi. Palët kanë detyrimin të njoftojnë menjëherë njëra tjetrën për ndryshimin e adresave, në të kundërt, njoftimet do të konsiderohen të kryera në adresat e mësipërme.

Vendi dhe Data

Vendi dhe Data

Nënshkrimi i Lojtarit, dhe

Nënshkrimi i Klubit

Nënshkrimi i Përfaqësuesit Ligjor
(për Lojtarët nën moshën 18 vjeç)

Shtojca 1 - Shpërblimi i Lojtarit

Më poshtë përcaktohet shpërblimi që do të përfitojë Lojtari gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, si kundërshpërblim për shërbimet e kryera ndaj Klubit.

i. Pagesa Mujore

- a. Vlera e pagesës mujore është _____
(_____) Lekë.
- b. Pagesa mujore paguhet në datën _____ të çdo muaji pasardhës.

ii. Këstet Kontraktuale

- a. Lojtari do të përfitojë shpërblime të tjera në formën e kësteve kontraktuale si më poshtë:

<i>Data e Pagesës së Kësteve Kontraktuale</i>	<i>Vlera e Këstit (në Lekë)</i>	<i>në fjalë</i>
	(nuk ka)	-
	(nuk ka)	-
	(nuk ka)	-
	(nuk ka)	-
	(nuk ka)	-

(nuk ka) -

Gjithsej (nuk ka) -

iii. Shpërblime të Tjera (fakultative)

- a. Lojtari do të përfitojë shpërblime të tjera në përputhje me kushtet si më poshtë:

<i>Kushti</i>	<i>Vlera e Shpërblimit (në Lekë)</i>	<i>në fjalë</i>
---------------	--------------------------------------	-----------------

- | | | |
|---|----------|---|
| 1. Aktivizimi në ndeshjet zyrtare deri në 50 (pesëdhjetë) minuta. | (nuk ka) | - |
| 2. Aktivizimi në ndeshjet zyrtare për më shumë se 50 (pesëdhjetë) minuta. | (nuk ka) | - |

b. Shpërblimet e tjera përlogariten në fund të çdo muaji dhe paguhen së bashku me pagesën mujore përkatëse në datën e përcaktuar në këtë Kontratë.

b. Lojtari nuk do të përfitojë shpërblimet e mësipërme në rastin e zhvillimit të ndeshjeve miqësore, ose ndeshjeve të kontrollit.

iv. Përfitime të Tjera

- a. Lojtari do të përfitojë si më poshtë:

Përfitime

(nuk ka)

(nuk ka)

(nuk ka)

- v. Zbatimi i Taksave dhe Tatimeve
 - a. Vlerat e shpërblimeve të përcaktuara në këtë Kontratë janë shprehur në shumat bruto.
 - b. Mbi pagesat kontraktuale që do të përfitojë Lojtari do të aplikohet legjislacioni tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- vi. Kryerja e Pagesave
 - a. Pagesat do t'i paguhen Lojtarit në llogarinë bankare që Lojtari paraqet pranë zyrës së financës së Klubit.
 - b. Klubi nuk mban përgjegjësi për vonesa të pagesave për shkak të kohëzgjatjes së ekzekutimit të transaksioneve në institucionet bankare.
- vii. Shuma Gjithsej e Kontratës
 - a. Shuma gjithsej e Kontratës përbëhet nga shumatorja e pagesave mujore dhe kësteve kontraktuale të përcaktuara në këtë Kontratë.






Vendi dhe Data	Vendi dhe Data
Nënshkrimi i Lojtarit, dhe nëse është e nevojshme, Nënshkrimi i Përfaqësuesit të tij. (Agjenti i Lojtarit, Avokati, etj.)	Nënshkrimi i Klubit
Nënshkrimi i Përfaqësuesit Ligjor (për Lojtarët nën moshën 18 vjeç)	Nënshkrimi i Agjentit (nëse ka)

ANEKSI 5 UNIFORMAT

Çdo klub duhet të sigurojë dhe të mbajë në gjendje funksionale 3 (tre) uniforma të ndryshme, një për ndeshjet në shtëpi (uniforma zyrtare) dhe dy të tjerat për ndeshjet në transfertë (uniforma e dytë dhe e tretë). Uniforma përmban bluzën, pantallonat, dhe getat.

Formular i deklarimit te uniformave

Klubi i Futbollit _____

Uniforma e parë	Uniforma e dytë	Uniforma e tretë	Portjeri i parë	Portjeri i dytë
				
Bluze:	Bluze:	Bluze:	Bluze:	Bluze:
Mbathje:	Mbathje:	Mbathje:	Mbathje:	Mbathje:
Geta:	Geta:	Geta:	Geta:	Geta:

ANEKSI 6

RREGULLORJA E FAIR-PLAY

Pas ndeshjes, delegati i ndeshjes duhet të plotësojë formularin e vlerësimit të Fair-Play në sistemin COMET duke u bazuar në kriteret si më poshtë:

Pika të veçanta në formën e vlerësimit

1. Kartona të kuq dhe të verdhë

Zbritje maksimumi prej 10 pikë:

- Karton i Verdhë - 1 pikë
- Karton i Kuq - 3 pikë

Nëse një lojtar i cili ka marrë një karton të verdhë kryen një vepër tjetër e cila normalisht do të ndëshkohet me një karton të verdhë të dytë, dhe del jashtë loje, do të hiqen vetëm 3 pikë pasi llogaritet si karton i kuq. Nëse, një lojtar që ka marrë një karton të verdhë kryen një tjetër vepër për të cilën ndëshkimi është karton i kuq direkt, një total prej 4 pikë (1 +3) do t'i zbriten ekipit në formular.

Kartoni i kuq dhe i verdhë, është pika e vetme që mund të marrë një vlerë negative.

2. Lojë pozitive

- Maksimum 10 pikë;
- Minimumi 1 pikë.

Qëllimi i këtij rregulli është që të shpërblejë lojën pozitive që është tërheqëse për spektatorët.

Në vlerësimin e lojës pozitive, aspektet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë:

Aspektet pozitive:

- Taktika sulmuese më shumë se sa taktika mbrojtëse;
- Përsheptimin e lojës;
- Përpjekjet për të fituar kohë;
- Ndjekjen e vazhdueshme të objektivave, edhe në qoftë se rezultati është në favor të ekipit që ka topin (p.sh. kualifikimin ose një hap larg barazim) që tashmë është arritur.

Aspektet negative:

- Ngadalësimin e lojës;
- Humbje të kohës;
- Taktika bazuar në faulla;
- Veprime në lojë etj.

Në terma të përgjithshme loja pozitive lidhet me numrin e golave të shënuar, shanset e krijuara dhe numrin e rasteve për të shënuar.

3. Respekt për kundërshtarët

- Maksimum 5 pikë;
- Minimalisht 1 pikë.

Lojtarët duhet të respektojnë ligjet e lojës, konkurrencën, rregulloret, kundërshtarët etj.

Vlerësimi duhet të bazohet në qëndrimet pozitive (p.sh. ndihmë për lojtarin e dëmtuar) dhe jo sjellje antisportive. Sjellja e paqëllimshme, por pa ndonjë qëndrim pozitiv apo gjeste ndaj kundërshtarëve, duhet të vlerësohet me notën 4 ose 5.

4. Respekti për arbitrat

- Maksimumi 5 pikë;
- Minimumi 1 pikë.

Lojtarët pritet të respektojnë arbitrat si persona, si dhe për vendimet që ata marrin. Numërimin të dyfishtë kundër “kartonave të kuqë dhe të verdhë” pika që duhet të shmanget. Megjithatë, delegati i ndeshjes mund të marrë parasysh seriozitetin e veprimeve që dënohen me kartona.

Një qëndrim pozitiv ndaj gjyqtarit duhet të shpërblehet nga vlerësime të larta, duke përfshirë edhe pranimin e vendimeve të dyshimta pa protestë. Sjellja normale, por pa ndonjë qëndrim të veçantë pozitiv apo gjeste në lidhje me arbitrat e ndeshjes, duhet të vlerësohet note 4 ose 5.

5. Sjellja e zyrtarëve të ekipit

- Maksimumi 5 pikë;
- Minimumi 1 pikë

Zyrtarët e ekipit, duke përfshirë edhe trajnerët, pritet të bëjnë çdo përpjekje për të rritur nivelin sportiv, teknik, taktik dhe moral të ekipit të tyre në të gjitha ndeshjet. Ata pritet gjithashtu të udhëzojnë lojtarët e tyre të sillen në një mënyrë fair-play e cila është në përputhje me parimet e lojës.

Aspektet pozitive dhe negative të sjelljes së zyrtarëve të ekipit duhet të vlerësohen; p.sh. nëse ata janë të qetë apo kanë provokuar lojtarë të zemëruar apo tifozë, se si ata pranojnë vendimet e gjyqtarit etj. Bashkëpunimi me median duhet të konsiderohet si faktor në vlerësimin. Sjellja e pafajshme, por pa ndonjë qëndrim të veçantë pozitiv apo gjeste, duhet të vlerësohet me notën 4 ose 5.

6. Sjellja e publikut

- Maksimum 5 pikë;
- Minimalisht 1 pikë.

Publiku është konsideruar të jetë një komponent i natyrshëm në një ndeshje futbolli. Mbështetja e tifozëve mund të kontribuojë në suksesin e ekipit të tyre. Publiku nuk pritet të shohë ndeshjen në

heshtje. Inkurajimi i ekipeve në stadium mund të ketë një ndikim pozitiv në atmosferë, në përputhje me frymën e lojës së ndershme. Publiku megjithatë, pritet që të respektojë ekipin kundërshtar dhe arbitrat. Ata duhet të vlerësojnë lojën e ekipit kundërshtar, edhe nëse ata dalin si fitues. Ata nuk duhet të asnjë mënyrë të bëjnë presion për të frikësuar ekipin kundërshtar, arbitrat apo mbështetësit e ekipit kundërshtar.

Një numër maksimal i pikëve (5) nuk duhet të jepet nëse të gjitha këto kërkesa nuk përmbushen. Ky nen është i zbatueshëm vetëm në qoftë se një numër i konsiderueshëm i tifozëve të ekipit në fjalë janë të pranishëm në stadium. Nëse numri i tifozëve të një ekipi është i papërfillshëm, kjo rregullore vlerësimi nuk aplikohet për ekipin në fjalë.

7. Ekipi që në fund të sezonit futbollistik përkatës ka grumbulluar më shumë pikë gjithsej, shpallet “Ekipi Fair-Play”.



ADRESA: SHTËPIA E FUTBOLLIT,
RRUGA: "LIMAN KABA", NR. 5
KODI POSTAR 1019, TIRANA, ALBANIA
TELEFON: +35542 346 601
FAX: +35542 346 609
E-MAIL: INFO@FSHF.AL



WWW.FSHF.ORG